

Akad. Prof. Dr. Vllado Kambovski
Prof. Dr. Gordana Llazhetiç

U DH Ë Z I M E

**PËR ZBATIMIN E
PARIMIT TË MOSDËNIMIT TË
VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT ME QENIE
NJERËZORE DHE TRAFIKIMIT ME FËMIJË**

Autorë: Akad. Prof. Dr. Vllado Kambovski
Prof. Dr. Gordana Llazhetiç
Përkthimi: Blerina Starova Zlatku

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.223:343.431-058.6]:340.13(497.7)
343.223:343.431-058.6-055.2]:340.13(497.7)
343.223:343.431-058.6]:341.24
343.223:343.431-058.6-055.2]:341.24

KAMBOVSKI, Vllado

Udhëzime për zbatimin e parimit të mosdënimit të viktimës së trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikimit me fëmijë / Vllado Kambovski, Gordana Llazhetiç. - Shkup : OBSE, 2020. - 50 стр. : граф. прикази ; 21 см

Библиографија: стр. 49-50

ISBN 978-608-4788-46-1

1. Llazhetiç, Gordana [автор]

а) Трговија со луѓе и деца - Жртва - Начело за неказнување - Законска регулатива - Македонија б) Трговија со луѓе и деца - Жртва - Начело за неказнување - Меѓународна регулатива COBISS.MK-ID 112394250

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

PËRMBAJTJA

REZYME EKZEKUTIVE	5
PSE NEVOJITEN UDHËZIME TË POSAÇME?	8
SEKSIONI I	
NOCIONI I VTQNJ DHE BAZAT E MOSDËNIMIT	12
1. Çka përfshin nocioni “viktimë e trafikimit me qenie njerëzore – VTQNJ”	12
2. Bazat e mosdënimit të VTQNJ të moshës madhore me klauzolë eksplicite	14
3. Bazat e mosdënimit të fëmijës VTQNJ	15
3.1. Klauzolë eksplicite për mosdënimin e fëmijës VTQNJ	16
3.2. Eksploatimi i fëmijës së pashoqëruar të huaj	18
SEKSIONI II	
DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE DHE PASQYRA KOMPARATIVE	19
1. Nga cilat dokumente ndërkombëtare buron klauzola e mosdënimit të VTQNJ?	19
2. Cilat modele të mosdënimit të VTQNJ ekzistojnë në legjislacionet e huaja?	25
SEKSIONI III	
SI TË INTERPRETOHEN DHE ZBATOHET DISPOZITAT E KP	29
1. Identifikimi i viktimës si aktivitet primar	29
1.1. Hapat e veprimit dhe mbrojtjes së viktimës potenciale të TQNJ	33
2. Baza të përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë së veprave të viktimës	34
3. Baza e posaçme personale për mosdënimin e viktimës (neni 418-a paragrafi 7 dhe neni 418-g paragrafi 8)	37
4. “E detyruar të kryej vepër penale”	38
5. “Vepra penale ose vepër tjetër e dënueshme e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me pozitën e saj të viktimës	39
6. Implikime procesuale ndaj VTQNJ	40
ANEKSI 1	
SHEMBUJ TË DISA VEPRIMEVE TË INKRIMINUARA QË MUND T’I NDËRMARRË PERSONI NË CILËSINË E VTQNJ PËR TË CILAT E MBRON KLAUZOLA E MOSDËNIMIT	47
ANEKSI 2	
VEPRIMI NË RAST TË DYSHIMIT TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE/FËMIJË	48
BIBLIOGRAFIA	49

SHKURTESA TË PËRDORURA

BE	Bashkimi Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore
KiE	Këshilli i Evropës
KP	Kodi Penal
KRMV	Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
LDF	Ligji për drejtësi për fëmijë
LPP	Ligji për procedurë penale
MNR	Mekanizmi Nacional për Referimin e VTQNJ pranë MPPS
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
NJNLKMTQNJ	Njësia Nationale për Luftimin e Kontrabandës me Migrantë dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSBE/ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PSO	Procedura Standarde Operative
QPS	Qendra për Punë Sociale
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
VTQNJ	Viktimë e trafikimit me qenie njerëzore

REZYME EKZEKUTIVE

Ky publikim ka për qëllim t'u ndihmojë organeve të zbulimit, ndjekjes dhe gjykimit të veprave të tregtisë me qenie njerëzore dhe fëmijë, si dhe organeve dhe institucioneve përgjegjëse për parandalim, identifikim, ndihmë dhe përkrahje, dhe përfaqësim ligjor të viktimave të këtyre veprave të rënda penale dhe shoqatave qytetare të cilat aktivisht punojnë në këtë drejtim, që sa më mirë ta kuptojnë dhe zbatojnë parimin e mosdënimit të VTQNJ. Në të janë përpunuar fushëveprimi dhe esenca e këtij parimi të ndërlikuar në përputhje me konventat dhe dokumentet ndërkombëtare dhe legjislacionin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me theks të posaçëm mbi ndryshimet e Kodit Penal (Gazeta Zyrtare e RM nr. 248/18) me të cilat është paraparë klauzolë për mosdënimin e viktimës nga tregtia me qenie njerëzore (neni 418-1, alineja 7) dhe vepra penale tregtia me fëmijë (neni 418-g, alineja 8).

Publikimi ka për qëllim t'u shërbejë si mjet praktik të gjithë subjekteve relevante në aktivitetet dhe përpjekjet e tyre për t'i njohur dhe përcaktuar pohimet për mosdënimin e VTQNJ, nga çka edhe varet veprimi dhe trajtimi i mëturjeshëm i viktimës. Parimi, gjegjësisht klauzola e mosdënimit duhet të kontribuoj në mbrojtjen e plotë të VTQNJ nga zbatimi i masave të detyrimit procesual (privimi nga liria, arrestimi), ngritja e procedurës penale, hapja e dosjes kriminale, dënimi dhe shqiptimi i sanksionit. Mosdënimi i VTQNJ do të mundësojë identifikim, ndihmë dhe përkrahje më efikase për viktimat, të cilat duke pasur parasysh gjendjen në të cilën janë, shpesh janë të detyruara nga trafikantët të kryejnë vepra tjera penale, ndërsa në të njëjtën kohë do t'i inkurajojë të bashkëpunojnë me organet ndjekëse në zbulimin dhe dënimin e autorëve të krimit.

Mbrojtja e përfshinë mosdënimin për vepra të kryera të cilat janë të dënueshme, përfshirë vepra penale dhe kundërvajtje. VTQNJ do të mbrohet tërësisht, vetëm nëse në mënyrë konsekuente njihet dhe zbatohet parimi i moskthimit të viktimës (pinciple of non refoulement) i cili e mbron viktimën nga transferimi ose dëbimi në shtet tjetër kur ekzistojnë baza të konsiderueshme të besimit se nëse personi transferohet do të ekspozohet në rrezik me dëm të parikuperueshëm gjatë kthimit, përfshirë këtu edhe ndjekjen, torturën, keqtrajtimin ose shkelje të tjera serioze të të drejtave të njeriut.

Dokumentet evropiane dhe ndërkombëtare insistojnë për "mosdënim efektiv" që nënkupton mungesë të dosjes kriminale të VTQNJ. Në këtë kontekst, mosdënimi në vetvete e ngërthen edhe mosndjekjen. Viktima potenciale e TQNJ nuk duhet të privohet nga liria, të arrestohet dhe të vendoset në institucionet e privimit nga liria, meqë kështu viktimizohet në mënyrë sekondare. Mbrojtjen e këtillë VTQNJ e ka edhe në rastin kur mohon se është trafikuar ose është e pavetëdijshme se është VTQNJ. Zbatimi i parimit të mosdënimit ka një rol të rëndësishëm si mjet që e fuqizon probabilitetin se viktima do të bashkëpunoj me organet e ndjekjes në zbulimin dhe dënimin e kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore, kundrejt pritshmërive të trafikantëve se viktima, nëse dënohet për veprat e kryera, do të jetë në anën e tyre dhe do t'i mbrojë nga ndjekja penale.

Inkriminimet në trafikimin me qenie njerëzore dhe fëmijë, neni 418-a dhe 418-g nga KP, janë komplekse dhe implikojnë përcaktim të dyfishtë të nocionit viktimë, me ç'rast VTQNJ bën pjesë në nocionin më të ngushtë të viktimës si person i cili ka përjetuar lëndim fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose lëndim tjetër ose rrezikim të lirive dhe të drejtave themelore të tij. Trafikimi me qenie njerëzore nënkupton veprime që i ndërmerr trafikanti me të cilat subjekti pasiv (personi i trafikuar) vihet në pozitë të mjetit për eksploatim të llojit të ndryshëm. Për realizimin e esencës ligjore të veprës nuk është i rëndësishëm ekzistimi

i pëlqimit të subjektit pasiv që të vihet ose të pranoj përlësi dhe marrëdhënie eksploatuese. Pëlqimi i fëmijës si viktimë nuk është i rëndësishëm për ekzistimin e veprës.

Për ekzistimin e trafikimit nuk është e nevojshme të jetë realizuar qëllimi i kryerësit, përkatësisht të ketë filluar eksploatimi.

Viktima mund të detyrohet të kryej vepra penale, siç janë vjedhjet, grabitjet, shpërndarja e lëndëve narkotike, mashtrimet, ndërsa nuk përjashtohen edhe veprat penale të kryera për lirimimin e saj ose arratisje nga kontrolli i trafikantit, siç është dhuna, lëndimi trupor, vrasja e trafikantit etj., të cilat, nëse janë përmbushur kushtet ligjore, mund ta fitojnë kualifikimin e veprave të kryera në mbrojtje të nevojshme.

Në legjislacionin penal maqedonas mosdënimi i viktimës së veprës penale trafikim me qenie njerëzore mundësohet me dispozitën eksplicite për mosdënimin e VTQNJ (neni 418-a paragrafi 7 të KP). Bazat e njëjta ekzistojnë edhe sa i përket fëmijës VTQNJ (neni 418-g paragrafi 8 të KP), ku në mënyrë plotësuese nevojitet të ofrohet mbrojtje e posaçme në rastin e eksploatimit të zbuluar të fëmijës së pashoqëruar të huaj. Kur moshja e viktimës është e panjohur dhe ka arsye që të besohet se është fëmijë, duhet të supozohet se është fëmijë dhe t'i nënshtrohet masave të veçanta të mbrojtjes. Fëmijët shpeshherë nuk e konsiderojnë vetveten si viktima të eksploatimit, e që në mënyrë plotësuese e komplikon identifikimin e tyre si viktima, dhe jo si kryerës.

Në kuadër të kushtit “e detyruar të kryej vepër penale” duhet të merret parasysh pozita në të cilën gjendet VTQNJ: gjendja e krizës personale, dobësia, varësia, nënshttrimi, frika, frikësimi, varësia, pasiguria, kufizimi i vullnetit të lirë dhe zgjedhja e lirë në sjelljen e saj e krijuar me kërcënimet aktuale ose të supozuara, gjendja e vazhdueshme e torturës fizike ose psikologjike. Ekzistimi i gjendjes së frikës, varësisë, frikësimit, pasigurisë, kufizimit të vullnetit të lirë, kërcënimit ose nevojës tek VTQNJ duhet të konstatohet me ekspertizë psikologjike.

Parimi i “mosdënimin”, e thekson statusin final të VTQNJ, ndërsa i paraprin mosprivimi nga liria, mosarrestimi, mosndjekja dhe mosdënimi. Më e rëndësishme për mosdënimin e VTQNJ është se përfitimin financiar nga veprat e kryera penale e shfrytëzon trafikanti me qenie njerëzore dhe jo VTQNJ.

Zbatimi i suksesshëm i klauzolës së mosdënimin e implikon nevojën e krijimit të sistemit të strukturuar funksional të mekanizmave për identifikimin dhe trajtimin e viktimave, të cilët i realizojnë detyrat e tyre përmes bashkëpunimit të koordinuar dhe të formalizuar në disa rrafshet. VTQNJ, nga autoritetet kompetente, duhet të pranoj ndihmë, mbrojtje dhe mbështetje të shpejtë, efektive dhe adekuate, por nga ana tjetër trafikanti me qenie njerëzore dhe fëmijë nuk guxon të mbetet i padënuar dhe t'i shmanget përgjegjësisë penale edhe atë jo vetëm për trafikimin me qenie njerëzore/fëmijë por edhe për ato vepra penale që i ka kryer VTQNJ në dobi të trafikantit, përmes detyrimit dhe në gjendje vulnerable. Pozita e vulnerabilitetit nënkupton situatë në të cilën personi i prekur nuk ka alternativë të mirëfilltë ose të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet keqpërdorimit, me ç'rast gjendja e “nevojës jetësore” është ekuivalente me shtrëngimin psikologjik ose fizik ndërkaq bëhet fjalë për rrethana të përafërta me “nevojën ekstreme”.

Personat e trafikuar – të huaj nuk duhet të arrestohen, akuzohen dhe dënohen për paligjshmërinë e hyrjes ose qëndrimit të tyre në vendin e transitit ose destinacionit, ose për përfshirjen e tyre në aktivitete të kundërligjshme në rastet kur një gjë e këtillë është si pasojë e drejtpërdrejt e statusit të tyre si persona të trafikuar. Në përputhje me aktet normative ndërkombëtare, nëse autoritetet kompetente kanë baza të arsyeshme të besojnë se ndonjë person ka qenë VTQNJ, çdo shtet e ka për detyrë të siguroj që ai person të mos dëbohet nga territori i tij deri në përfundimin e procesit të identifikimit të tij. Sipas Ligjit për të huaj nëse ekzistojnë baza për dyshim se i huaji është VTQNJ ose fëmijë i pashoqëruar, do t'i lejohet

qëndrim i përkohshëm për shkaqe humanitare edhe pse nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me ligj për lejimin e qëndrimit të përkohshëm.

Në këtë publikim janë prezantuar gjetje dhe opinione të personave ekspert lidhur me vlerësimin e gjendjes psikike në të cilën ka qenë VTQNJ, janë përfshirë shembuj nga praktika relevante gjyqësore në rastet e trafikimit me fëmijë, si dhe aktgjykime të GJEDNJ në lidhje me pritshmëritë e mënyrës së veprimit të autoriteteve vendore për ndjekjen dhe identifikimin e viktimës që kanë të bëjnë me aspektet e ndalimit të skllavërisë dhe punës me detyrim nga neni 4 i KEDNJ.

Të drejtat që i posedon VTQNJ në lidhje me ndihmën juridike falas dhe format procesuale për mbrojtje të rregulluara me LPP përkatësisht me Ligjin për drejtësi për fëmijë nuk janë përfshirë në këtë publikim.

PSE NEVOJITEN UDHËZIME TË POSAÇME?

Udhëzimet kanë të bëjnë me veprimin e organeve dhe subjekteve relevante pas dyshimit të parë se ndoshta në rastin konkret bëhet fjalë për viktimë potenciale të TQNJ. Dyshimi bazohet në ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të caktuara të cilat i paraprijnë identifikimit formal të personit si VTQNJ dhe janë në funksion të vlerësimit të gjendjes konform indikatorëve, bashkëpunimit të koordinuar interdisiplinor dhe ndërministror, përkujdesjes fillestare të personit, akomodimit të tij dhe ndihmës përkatëse mjekësore, përkatësisht psikologjike.

Veprimi i organeve me qëllim të përkujdesjes, ndihmës, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimës potenciale të TQNJ nuk është i kushtëzuar nga bashkëpunimi i personit nëse më vonë me të vërtetë identifikohet si VTQNJ.

Në bazë të analizës gjithëpërfshirëse mbi konventat ndërkombëtare obligative dhe mbi dokumentet e tjera (Konventa e OKB-së, KiE, Direktivat e BE), udhëzime dhe modele ndërkombëtare (rekomandimet e Përfaqësuesit të Lartë pranë OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe trafikimin me qenie njerëzore dhe autoriteteve të tjerë ndërkombëtare), legjislacionin dhe praktikat komparative dhe sistemin juridik nacional (KP dhe LPP), udhëzimet e përfshira në këtë publikim synojnë të ofrojnë shpjegime dhe precizime plotësuese të zgjidhjeve ligjore, të vendosura në kontekstin e modeleve ekzistuese komparative për zgjidhjen e çështjes së mosdënimit të VTQNJ, në përputhje me parimet e sistemit nacional juridik.

Parimi i mosdënimit efektiv të VTQNJ mund të cenohet në mënyrë të tërthortë: mos-suksesi i organeve të detektojnë dyshim për viktimë potenciale të TQNJ ose në mënyrë të drejtpërdrejt: kur zhvillohet procedurë penale kundër VTQNJ, kështu që personi depërtohet, ndiqet, privohet nga liria dhe sanksionohet.

Së këtejmi, në fokusin e analizës dhe rekomandimeve është interpretimi i dispozitave të parashikuara të reja në KP (neni 418-a paragrafi 7 dhe neni 418-g paragrafi 8) për mosdënimin e VTQNJ dhe përcaktimin e veprimit të drejtë të policisë, prokurorisë publike dhe trupave, organeve dhe institucioneve të tjera të përfshira në procedurën e identifikimit të VTQNJ, me qëllim të zbatimit të drejtë të këtyre dispozitave të KP.

Përgjigjet në pyetjet që i ofron ky publikim kanë për qëllim t'u ndihmojnë organeve të zbulimit, ndjekjes dhe gjykimit, ta identifikojnë viktimën potenciale dhe t'i detektojnë dhe specifikojnë supozimet e mosdënimit të saj.

Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore u ekspozohen pasojave të shumta si rezultat i pozitës në të cilën gjenden. Përveç shkeljes së dinjitetit të tyre njerëzor, rrezikimit të jetës dhe shëndetit për shkak të sjelljes johumane të trafikantit ndaj tyre, viktimat shpeshherë involvohen edhe në veprime me të cilat përmbushet esenca e kundërvajtjeve ose veprave të caktuara penale.

Duke e pasur parasysh gjendjen e viktimës së trafikimit me qenie njerëzore dhe pasojat që ndërliken me pozitën e këtillë, dokumentet ndërkombëtare insistojnë që ligjvënësit nacional të përcaktojnë dispozitë eksplicite e cila do ta përmbaj klauzolën e mosdënimit të viktimës së trafikimit me qenie njerëzore për veprat që i ka kryer derisa ka qenë viktimë ose veprat që ndërliken me pozitën e viktimës së trafikimit me qenie njerëzore.

Klauzola e mosdënimit në vetvete e ngërthen detyrimin për shmangien e privimit nga liria dhe arrestimin e viktimës, mosngritje të procedurës penale kundër saj përkatësisht mosshqiptim të sanksionit penal.

Udhëzimet për mosdënimin e VTQNJ janë përgatitur në bazë të analizës së çështjeve komplekse për caktimin e statusit të viktimës dhe ndërlidhjes së veprave penale dhe aktiviteteve të palejuara me statusin e këtillë, si dhe të bazave juridike për mosdënimin e saj e që janë përcaktuar si supozime juridike-materiale dhe juridike-procesuale për: përjashtimin e veprimit, përjashtimin e kundërligjshmërisë, përjashtimin e fajit ose lirimin nga dënimi. Përcaktimi i ekzistimit të bazave të këtilla në procesin e identifikimit të viktimës ka ndikim mbi mosngritjen e procedurës penale, ndërprerjen e procedurës, miratimin e aktgjyqimit lirues ose refuzues ose lirimin nga dënimi.

Përgatitja e këtij publikimi rezulton pikërisht nga nevoja e zbatimit konsekuent të konventave ndërkombëtare për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore (neni 418-a), të cilat parashikojnë klauzolë për mosdënimin e veprave të kryera nga viktimat e inkriminuara në vepra të caktuara dhe në kushte të caktuara, dhe të dispozitave të amenduara të KP (neni 418-a, paragrafi 7 dhe 418-g, paragrafi 8), me të cilat kjo klauzolë është sanksionuar në legjislacionin tonë.

Përvojat preliminare lidhur me zbatimin e dispozitave për mosdënimin e VTQNJ e vënë në dukje nevojën e interpretimit të tyre, me ç'rast do të lehtësohet zbatimi i tyre, duke iu dhënë përgjigje një vargu të pyetjeve të hapura: cili person ka status të viktimës, kush është statusi i kategorive të veçanta vulnerable – gra dhe fëmijë, në cilat vepra mund të përjashtohet dënimi i viktimës së trafikuar, në cilat kushte dhe madje a mund të përgjigjet viktimat për vepra të caktuara të kryera në pozitën e viktimës.

Në të vërtetë udhëzimet e hartuara në bazë të një analize gjithëpërfshirëse komparative, mbështeten në disa supozime metodologjike:

- Fillimisht duhet ti referohemi supozimit se viktimat e një krimi të këtillë të rëndë parimisht nuk duhet të përgjigjet për veprat penale të kryera në pozitë të viktimës, e që është një element i funksionit mbrojtës për ndalimin e trafikimit me qenie njerëzore. Qëndrimi i këtillë parimor e implikon zbatimin e parimit “*in dubio pro libertate*”, në rastet në të cilat ekziston dyshimi se a janë plotësuar supozimet e mosdënimit;
- Klauzola e mosdënimit të viktimës ka të bëjë me një sërë të kushteve objektive (vet statusi i viktimës, i përcaktuar sipas përmbushjes së veçorive të ndonjë forme të trafikimit), por edhe subjektive (gjendje e fuqisë kompulsive, përkatësisht detyrimi psikik, mashtrimi, premtime për ndonjë përfitim etj.), të cilat mund të radhiten sipas intensitetit ose ndikimit psikik. Prandaj, në procedurën e identifikimit të viktimës e cila i plotëson këto kushte doemos duhet të respektohet qasja skajshmërisht e individualizuar;
- Sipas zgjidhjes legjislative në legjislacionin tonë penal, i cili parashikon edhe bazë të përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë (nevojë ekstreme), por edhe bazë të veçantë për mosdënim (neni 418-a paragrafi 7 dhe neni 418-g paragrafi 8), nevojitet që në çdo rast konkret të identifikohen dhe përcaktohen kushtet e veçanta për zbatimin ose të dispozitës së përgjithshme ose të dispozitës së posaçme;
- Përveç veprimit material-juridik të klauzolës së mosdënimit, kryerja e veprës së penale nga viktimat në kushtet që i ofrojnë privilegje të këtilla ka edhe shumë aspekte penale-procesuale: mbrojtja procesuale e të drejtave të viktimës, shfrytëzimi i saj si dëshmitar i mbrojtur, mundësia që i akuzuari në procedurën penale të dëshmojë se

është viktimë dhe se i përmbush kushtet e mosdënimit, mundësia për zbatimin e parimit të oportunitetit të prokurorit publike etj;

- Përkundrejt sistemit ekzistues të parandalimit dhe represionit të trafikimit me qenie njerëzore, është e domosdoshme të krijohet bashkëpunimi i strukturuar dhe i formalizuar si dhe procedura dhe standarde të qarta gjatë veprimit të policisë dhe të organeve të tjera të zbulimit të kësaj forme të krimit, me prokurorinë publike, si dhe përgatitje të mirë të prokurorisë publike gjatë hetimit të akuzës sipas së cilës duhet të procedoj gjykata, duke i respektuar të gjitha standardet e sanksionuara në dokumentet ndërkombëtare dhe në legjislacionin penal nacional.

Me qëllim të jetësimit efektiv të kësaj klauzole me rëndësi të madhe është identifikimi në kohë i VTQNJ me qëllim të shmangies së viktimizimit sekondar me veprimet që ndaj saj do të ndërmerreshin si ndaj personit të dyshuar.

Identifikimi në kohë dhe i drejtë është jashtëzakonisht i rëndësishëm nëse kemi parasysh faktin se në shtetin tonë kemi një tendencë në rritje të trafikimit të brendshëm me qenie njerëzore dhe veçanërisht me fëmijë, e cila për shkak të mënyrës së kryerjes në praktikë krijon probleme dhe vështirësi serioze për zbulim dhe dokumentim.

Në përputhje me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), procedura e identifikimit të viktimës doemos duhet të ketë kohëzgjatje të arsyeshme me qëllim që VTQNJ t'i sigurohet ndihmë dhe mbështetje adekuate dhe në kohë.



L.E. v. Greece
Application no. 71545/12
Final Judgment
21/04/2016

Rasti

ka të bëjë me aplikimin e shtetases nga Nigeria, e cila u eksploatua për prostitucion në Greqi.

Edhe pse zyrtarisht është identifikuar si VTQNJ për eksploatim seksual, megjithatë, kanë kaluar më shumë se nëntë muaj nga njoftimi i autoriteteve kompetente për gjendjen e saj të statusit të VTQNJ. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konstatoi një sërë parregullsish gjatë hetimit preliminar dhe shqyrtimit të mëtutjeshëm të rastit, si dhe prolongime dhe lëshime të njëpasnjëshme, në lidhje me detyrimet procedurale të autoriteteve greke.

Në aktgjykim GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 4 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (ndalim i skllavërisë dhe punës së detyrueshme), shkelje të nenit 6 paragrafi 1 nga KEDNJ (e drejta e seancave të ndershme në afat të arsyeshëm) dhe shkelje të nenit 13 nga KEDNJ (e drejta e mjetit efektiv)

Trajtimi i koordinuar dhe i drejtë i VTQNJ plotësisht duhet të korrespondojë me parimet themelore të sistemit juridik maqedonas dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe mënyrën e trajtimit të VTQNJ.

Me qëllim që të evitohet viktimizimi sekondar i VTQNJ duhet të merren parasysh edhe dispozitat e Ligjit për të huaj nga viti 2018 (neni 10), me ç'rast i huaji për të cilin ekzistojnë baza të dyshimit se është VTQNJ ose fëmijë i pashoqëruar për të cilin ekzistojnë baza të dyshimit

se është VTQNJ, nuk llogaritet se kanë bërë hyrje të paligjshme në shtet. Në kuadër të hyrjes së paligjshme bëjnë pjesë: kalimi i kufirit shtetëror jashtë vendit, koha ose mënyra e përcaktuar për kalimin e kufirit shtetëror; nëse i përvidhet kontrollit kufitar; nëse gjatë hyrjes përdor dokumente udhëtimi ose dokumente tjera të falsifikuara të ndonjë personi tjetër ose të pavlefshme të përcaktuara për kalimin e kufirit shtetëror; nëse hyn në shtet para skadimit të ndalimit për hyrje. Për të gjitha veprimet e theksuara, i huaji i cili është VTQNJ nuk ka përgjegjësi. Në rastin kur do të zbulohet fëmijë i pashoqëruar i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit tonë, MPB e ka për detyrë menjëherë ta njoftoj përfaqësinë diplomatike-konsullore të shtetit shtetas i të cilit është fëmija (me qëllim të përcaktimit të anëtarëve të familjes së tij më të ngushtë) dhe QPS (me qëllim që të caktohet kujdestari në përputhje me ligjin).

SEKSIONI I

NOCIONI I VTQNJ DHE BAZAT E MOSDËNIMIT

1. Çka përfshin nocioni “viktimë e trafikimit me qenie njerëzore – VTQNJ”

Zbatimi i parimit të mosdënimit nënkupton përcaktim më të saktë të nocionit “viktimë e trafikimit me qenie njerëzore”, për të cilin edhe në dokumentet ndërkombëtare përdoren shprehje të ndryshme (përveç shprehjes së përmendur edhe “person i trafikuar”). Në përkufizimet legale të KP (neni 122) nocioni “viktimë” është përcaktuar në mënyrë ekstensive: “me viktimë të veprës penale nënkuptohet çdo person i cili ka pësuar dëm, duke e përfshirë lëndimin fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale ose shkelje tjetër apo rrezikim të lirive dhe të drejtave themelore të saj si pasojë e veprës së kryer penale. Me nocionin fëmijë viktimë e veprës penale nënkuptohet personi i mitur deri në moshën 18 vjeçare.”

Në Direktivën 2012/29/BE për përcaktimin e standardeve minimale të të drejtave, mbështetja dhe mbrojtja e shteteve nga krimi me të cilën u zëvendësua Vendimi Kornizë i Këshillit 2001/220/JHA (*Directive 2012/29/EU establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA*), në përputhje me nenin 2, nocioni “viktimë” përfshin dy kategori: i) person fizik i cili ka pësuar dëm, përfshirë këtu edhe dëmtimin fizik, mendor ose emocional ose humbje ekonomike e cila është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vepra penale; dhe ii) anëtarët e familjes së personit vdekja e të cilit është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejt nga vepra penale dhe të cilët kanë pësuar dëm si rezultat i vdekjes së atij personi.

Inkriminimet në trafikimin me qenie njerëzore dhe fëmijë (neni 418-a dhe 418-g) janë komplekse dhe implikojnë përcaktim të dyfishtë të nocionit - viktimë: në kuptimin më të gjerë dhe më të ngushtë. Në kuptimin më të gjerë, në përputhje me përkufizimin ligjor (neni 122 KP), ky nocion e përfshin çdo person i cili ka pësuar dëm si pasojë e veprës: për shembull, e këtillë mund të jetë, nëna fëmija i së cilës është rrëmbyer për eksploatim për prostitucion, lypja dhe ngjashëm, pronari i automjetit të dëmtuar gjatë transportit të personit të trafikuar etj. Kuptimi i dispozitës për mosdënim, zbatimi i së cilës e presupozon ekzistimin e probabilitetit, përkatësisht dyshimin se një person i caktuar është VTQNJ, nuk e nënkupton zgjerimin e saj të veprave penale ose të veprimeve të tjera të paligjshme nga persona të cilët nuk kanë status të personit të trafikuar. Ajo e vë në dukje personin e trafikuar si person i cili gjendet në një pozitë dhe rrethanë jashtëzakonisht vulnerabile, me ç'rast është e rëndësishme të theksohet se këtë mbrojtje e posedon personi sipas pozitës së viktimës potenciale e cila nuk duhet të ndërlihet me cilësinë procesuale të “viktimës” në procedurën penale.

Së këtëjmi, nocioni i viktimës, në aspektin e kuptimit më të ngushtë “person i trafikuar”, duhet të rezultojë nga përkufizimi ligjor të këtij inkriminimi dhe veprimet e kryerjes të fokusuar mbi personin të cilin kryerësi ka për qëllim ta shfrytëzoj si mjet për eksploatim.

Në përputhje me përkufizimet e këtij inkriminimi në Konventën e Këshillit të Evropës dhe Protokollin e OKB-së, esenca ligjore e veprës bazike të trafikimit me qenie njerëzore në Kodin Penal (neni 418-a paragrafi 1) është komponuar nga më shumë veprime alternative të kryerjes; rekrutim, transportim, transferim, blerje, shitje ose pranim të personave për eksploatim. Bëhet fjalë për veprime me të cilat subjekti pasiv (personi i trafikuar) vihet në pozitën e mjetit për eksploatim të llojeve të ndryshme: prostitucion ose forma të tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë me detyrim ose robëri, skllavëri, martesë me detyrim, shtatzëni me detyrim, adoptim i paligjshëm apo veprim i ngjashëm me këtë, lypje ose eksploatim me qëllim të aktivitetit të ndaluar me ligj ose transplantim i palejueshëm i pjesëve të trupit të njeriut.

Esenca komplekse e veprës përfshinë edhe më shumë mënyra të kryerjes së veprimeve alternative: përdorimi i forcës, kërcënim serioz, vënia në lajthitje ose forma të tjera të

shtrëngimit, rrëmbim, mashtrim, shpërdorim të pozitës së vet, keqpërdorim të gjendjes së shtatzënisë, pafuqi ose paaftësi fizike ose mendore i personit tjetër, dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimit tjetër, për shkak të dhënies së pëlqimit personit i cili ka kontroll mbi një person tjetër ose në mënyrë tjetër. Në mënyrë tjetër nënkuptohet çdo veprim i cili për pasojë e ka pëlqimin me dhunë ose pëlqimin me shtrëngim dhe me këtë vënie e subjektit pasiv në marrëdhënie robërie, të nënshtruar ndaj kryerësit ose ndaj personave të tretë për eksploatim (duke premtuar martesë, punësim, lënien e personit në kushte të vështira jetësore etj.).



Rast nga praktika

...në bazë të bisedave telefonike të interpretuara ndërmjet të akuzuarit dhe fëmijës VTQNJ, është mjaft e qartë se e ka dërguar në objektin e tij me qëllim që të merret me prostitucion por edhe atë se ka pasur plane krejtësisht të ndryshme nga ato që ia ka thënë në fillim, kur ia ka zgjidhur problemin e saj financiar me atë që e ka punësuar në kafeterinë e tij...

Në këtë kontekst, për realizimin e esencës ligjore të veprës nuk është i rëndësishëm ekzistimi i pëlqimit të subjektit pasiv që të vihet në pozitë ose të pranoj përlësi ose marrëdhënie eksploatimi; pëlqimi i viktimës me realizimin e qëllimit të kryerësit (eksploatim) nuk është i rëndësishëm për ekzistimin e veprës (paragrafi 5), madje presupozohet tek disa forma të veprës (dhënie ose marrje të pagesave etj.). Nga ana tjetër, për ekzistimin e veprës nuk është e domosdoshme të realizohet qëllimi i kryerësit, përkatësisht subjekti pasiv të filloj të shfrytëzohet nga ai ose nga persona të tjerë për lloje të ndryshme të eksploatimit. Viktimë e veprës mund të jetë një ose më shumë persona. Nëse vepra është kryer njëkohësisht, me veprim të njëjtë dhe në mënyrë të njëjtë ndaj më shumë viktimave, do të ekzistoj një vepër, dhe jo më shumë vepra të bashkëveprimit (kështu, për shembull, nëse kryerësi me kërcënim strehon më shumë persona femra për prostitucion).

...i akuzuari, i cili i transporton fëmijët e vet dhe fëmijët e miqve të tij për lypje nga një vend në një vend tjetër, edhe pse gjatë kësaj nuk ka përdorur forcë dhe kërcënime dhe nuk e ka keqpërdorur gjendjen e vështirë ose besimin e personit tjetër, megjithatë me veprimet që i ka ndërmarë është përmbushur esenca ligjore e veprës penale trafikim me fëmijë...



Rast nga praktika

Për më tepër, subjekti pasiv nuk mund të paraqitet si pjesëmarrës i veprës edhe atëherë kur ai ka marrë pjesë aktive në kryerjen e saj, përveç rastit kur jep pëlqim për trafikimin e personit mbi të cilin ka kontroll (për shembull, prindi e shet fëmijën e vet).

I ngjashëm është përkufizimi ligjor i inkriminimit të trafikimit me fëmijë (neni 418-g KP), me atë se esenca ligjore e veprës themelore (paragrafi 1) përveç veprimeve të tjera (rekrutim, transportim etj.) e nënkupton edhe manipulimin e fëmijës për kryerjen e veprimeve seksuale ose mundësimin e kryerjes së veprimeve seksuale me fëmijë. Në përputhje me Konventën e KiE (neni 4 - përkufizime) rekrutimi, transportimi dhe transferimi etj. i fëmijës për qëllime eksploatimi konsiderohet si trafikim me qenie njerëzore edhe nëse nuk janë kryer në mënyrën e kryerjes së veprës themelore të trafikimit me të rritur (forcë, kërcënim etj.). Prandaj, kryerja

e veprës përmes përdorimit të forcës, kërcënimit etj. është parashikuar si formë më e rëndë e veprës themelore trafikim me fëmijë (neni 418-g paragrafi 2). Nga ana tjetër, eksploatimi është specifikuar si qëllim i kryerësit, përveç formave të tjera të shfrytëzimit të fëmijës në aktivitete seksuale për kompensim në para ose kompensim tjetër ose shtrëngim për dhënien e pëlqimit si ndërmjetësues që të adoptohet fëmija (këtu viktima në kuptimin më të gjerë është person tjetër). Pëlqimi i fëmijës si viktimë nuk ka rëndësi për ekzistimin e veprës (paragrafi 6).

Tek të dy inkriminimet, për përcaktimin e rëndësisë së përdorimit të forcës, është relevant përkufizimi ligjor i këtij nocioni (neni 122 KP): si forcë konsiderohet edhe aplikimi i hipnozës dhe mjeteve për mashtrim me qëllim që person i caktuar të vihet në pozitë kundër vullnetit të tij në gjendje të pavetëdijshme ose të paaftësohet për rezistencë. Për përkufizimin e këtij nocioni, në kuptimin më të gjerë, është relevant edhe përcaktimi i nocionit “dhunë” në përkufizimin ligjor të nocionit “dhunë në familje”, siç është “keqtrajtimi”, ofendimet e vrazhda, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna seksuale ose dhunë tjetër psikike ose fizike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frikës” (neni 122 paragrafi 21).

Viktima e trafikimit me qenie njerëzore diferencohet nga viktima e veprave tjera të përafërta, siç është inkriminimi për vendosjen e marrëdhënies skllavëruese dhe transportimit të personave në marrëdhënie skllavëruese (neni 418 KP) dhe kontrabanda me migrantë (neni 418-b KP), sipas mungesës së qëllimit të posaçëm të kryerësit të veprës që është element konstituiv i esencës ligjore – shfrytëzimi i viktimës me qëllim të eksploatimit të specifikuar si prostitucion, pornografi, punë me detyrim, eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj etj.

2. Bazat e mosdënimit të VTQNJ të moshës madhore me klauzolë eksplicite

Klauzola e mosdënimit duhet të kontribuoj në mbrojtjen e plotë të VTQNJ nga aplikimi i masave të detyrimit procesual (privimi nga liria, arrestimi), ngritja e procedurës penale, pranimi i dosjes kriminale, shqiptimi i sanksionit dhe ngjashëm.

Mënyra eksplicite e mbrojtjes së VTQNJ nga ndjekja penale përfshihet në klauzolën e mosdënimit të viktimës, e cila si dispozitë e veçantë është inkorporuar me ndryshimet dhe plotësimet e KP në vitin 2018.

Trafikimi me qenie njerëzore (Neni 418-a paragrafi 7)

“(7) Nuk do të dënohet viktima e trafikimit me qenie njerëzore e cila ka qenë e detyruar të kryej vepër penale ose vepër tjetër të dënueshme derisa ka qenë viktimë, ndërsa e njëjta në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet me pozitën e saj si viktimë.”

Kjo klauzolë për mosdënimin e viktimës zbatohet pa marrë parasysh formën e eksploatimit që ka qenë qëllimi i trafikimit me qenie njerëzore.

Interpretimi dhe zbatimi i drejtë i saj duhet të jetë në korrelacion me nevojën ekstreme të përcaktuar në KP, si bazë e përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë.

Nevoja ekstreme (Neni 10)

“(1) Nuk është vepër penale ajo vepër që është kryer në nevojë ekstreme.

(2) Nevoja ekstreme ekziston kur vepra është kryer me qëllim që kryerësi ta largojë nga vetvetja ose nga tjetri rrezikun e njëkohshëm evident i cili në mënyrë tjetër nuk ka mundur të largohet, me ç’rast krimi i kryer nuk është më i madh se krimi që u është kërcënuar.

(3) Kryerësi, i cili ka shkaktuar rrezik nga pakujdesia ose i ka tejkaluar kufijtë e nevojës ekstreme, mund të dënohet me dënim më të butë, ndërsa nëse tejkalimi është bërë në rrethana veçanërisht lehtësuese-mund të lirohet nga dënimi.

(4) Nuk ka nevojë ekstreme nëse kryerësi është detyruar të ekspozohet në rrezik.”

Direktiva BE nr. 36 nga viti 2011 në nenin 2 paragrafin 3 në mënyrë eksplicite e përcakton eksploatimin për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj midis formave të eksploatimit që mund të jenë motiv për trafikantin me njerëz. Kjo formë e eksploatimit më së shpeshti manifestohet përmes kryerjes së veprave penale duke filluar nga vjedhjet e xhepit, vjedhjet, vjedhjet e rënda, grabitjet e deri në kontrabandë me drogë, armë, migrantë dhe ngjashëm.

Më e rëndësi për mosdënimin e VTQNJ është se përfitimin financiar nga veprat e kryera penale e shfrytëzon trafikanti me qenie njerëzore dhe jo VTQNJ

Forma e veçantë e eksploatimit – eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj, në kuadër të dispozitës së veprës penale Trafikim me qenie njerëzore ekziston në KP nga viti 2002:

Trafikimi me qenie njerëzore (neni 418-a, paragrafi 1)

“(1) Ai i cili me forcë, kërcënim serioz e vë në lajthitje ose forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, me shpërdorimin e pozitës së tij ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore të personit tjetër, ose me dhënie ose marrje të pagesave ose përfitimit tjetër me qëllim të marrjes së pëlqimit nga personi i cili ka kontroll mbi person tjetër ose në mënyrë tjetër rekruton, transporton, transferon, blen, shet, strehon ose pranon persona për eksploatim përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë me detyrim ose robëri, skllavëri, martesë me detyrim, shtatzëni me detyrim, adoptim i paligjshëm ose marrëdhënie të ngjashme me këtë, lypje ose eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj ose transplantim i palejueshëm i pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me dënim me burgim me më së paku katër vjet.”

Ligjvënësi e ka parashikuar këtë formë të eksploatimit duke e pasur parasysh faktin se VTQNJ ndërmer veprime inkriminuese për shkak të pozitës në të cilën gjendet në raport me trafikantin, e pafuqishme që të kundërvihet, shpeshherë duke pasur frikë për shëndetin ose jetën e saj.



Gjetjet e personit ekspert në lidhje me VTQNJ

...e dëmtuara është pranuar në gjendje stresi, me sqarimin se e njëjta para dymbëdhjetë orësh është keqtrajtuar fizikisht nga dy persona që i ka njohur, dhe prandaj ka pasur frikë, shqetësim dhe dhimbje në trup...

Me formën e veçantë të përcaktuar të eksploatimit, ligjvënësi e ka pamundësuar qëllimin e trafikantit që përmes VTQNJ të ndërmerren veprime të palejueshme dhe të rezultojë me atë që trafikanti t'i shmanget përgjegjësisë penale për veprimet që i ka ndërmarrë VTQNJ e detyruar nga trafikanti.

3. Bazat e mosdënimin të fëmijës VTQNJ

Së këtëjmi, edhe sa i përket VTQNJ të moshës madhore, ligjvënësi e ka përcaktuar mosdënimin e fëmijës VTQNJ. Duhet të reagohe në mënyrë efektive dhe duhet të ofrohet mbrojtje e veçantë në rast të eksploatimit të zbuluar të fëmijës së pashoqëruar të huaj.

Me ndryshimet e KP nga viti 2018 ("Gazeta Zyrtare e RM", nr. 248), për këtë analizë është i rëndësishëm edhe riprecizimi i nocionit "dhunë ndaj fëmijës" (neni 122 paragrafi 41), me çka nënkuptohet "edhe dhuna psikike, dhuna përmes internetit, dhuna midis moshatarëve, si dhe përgjimi dhe ndjekja e fëmijës". Me riprecizimin e këtij nocioni ofrohet përmbajtje më e gjerë e nocionit të dhunës si element i veprimit të trafikimit me fëmijë, dhe me këtë edhe të viktimës së tij.

3.1. Klauzolë eksplicite për mosdënimin e fëmijës VTQNJ

Edhe fëmija VTQNJ në mënyrë eksplicite është mbrojtur nga mosdënimin me klauzolë të posaçme të përcaktuar në veprën penale Trafikim me fëmijë në nenin 418-g paragrafin 8, e cila është inkorporuar me ndryshimet dhe plotësimet e KP në vitin 2018:

Trafikimi me fëmijë (Neni 418-g, paragrafi 8)

"(8) Nuk do të dënohet fëmija – viktimë e trafikimit me qenie njerëzore në rastet në të cilat ligji e parashikon dënimin e fëmijës, kur kryerësi i veprës penale e ka detyruar të kryej veprë penale, nëse veprimi i atillë i tij është pasojë e drejtpërdrejt e pozitës së tij të viktimës."

Duke i pasur parasysh obligimet e ndërmarra nga dokumentet ndërkombëtare, në çdo rast kur fëmija do të paraqitet si VTQNJ në të vërtetë nënkupton se shteti nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme që ta parandaloj viktimizimin e fëmijës dhe së këtijmi në vend të sanksionimit, fëmija duhet t'u nënshtrohet masave për ndihmë, përkujdesje dhe mbrojtje. Masat e këtylla kanë qëllim të dyfishtë: t'i zvogëlojnë pasojat e krijuara nga përfshirja e fëmijës në zinxhirin e trafikimit me qenie njerëzore dhe ta parandalojnë viktimizimin sekondar të fëmijës i cili ka qenë VTQNJ.

Në këtë kontekst duhet të interpretohet dhe zbatohet parimi i mosdënimin të fëmijës VTQNJ në rastet kur trafikanti me fëmijë e ka detyruar të ndërmarrë veprime të cilat kanë karakteristika të ndonjë veprë penale. Duke e pasur parasysh moshën, pëlqimi i fëmijës është irelevant dhe nuk e përjashton zbatimin e klauzolës për mosdënim. Me fjalë të tjera, klauzola për mosdënim ndaj fëmijës VTQNJ zbatohet pavarësisht faktit se a ka bashkëpunuar fëmija me trafikantin ose jo, a e ka kundërshtuar, a ka manifestuar mospajtim ose nuk ka pasur kurrfarë reagimi.

Forma e veçantë e eksploatimit për shkak të aktivitetit të ndaluara me ligj është e pranishme tek fëmijët VTQNJ. Fëmijët frikësohen më lehtë, kështu që tregtarët u kërcënohen dhe përdorin metoda të ndryshme për manipulim psikologjik me qëllim që të realizohet eksploatimi. Zakonisht bëhet fjalë për fëmijë nga familje në gjendje të rëndë ekonomike, kështu që familjet i shesin fëmijët e tyre ose rekrutohen gra shtatzëna të cilat detyrohen t'i shesin bebet/foshnjat e tyre. Në nivel evropian është detektuar se rastet e trafikimit me fëmijë për shkak të eksploatimit gjatë lypjes së detyrueshme ose aktivitetit të detyrueshëm kriminal shpeshherë gabimisht llogariten si kundërvajtje kundër rendit publik ose si vepra më të lehta penale. Aktivitetet kriminale që i kryejnë fëmijët me detyrimin e trafikantit përfshijnë vepra penale të ndërlidhura me prodhimin, shpërndarjen ose kontrabandën me drogë, forma të ndryshme të veprave penale pronësore, mashtrime që kanë të bëjnë me ndihmën sociale dhe lypjen e organizuar. Në Britaninë e Madhe fëmijë nga Vietnami shpeshherë shfrytëzohen për prodhimin e marihuanës. Llojet e tjera të eksploatimit, përveç eksploatimit seksual ose të punës, detektohen dhe denoncohen në masë të pamjaftueshme (EUROPOL, 2014).

Mosidentifikimi se fëmija i cili ka ndërmarrë veprime inkriminuese në të vërtetë është VTQNJ ka të bëjë me mënyrën e kryerjes së kësaj forme të eksploatimit. Me fjalë të tjera, viktima nuk është e domosdoshme të shoqërohet nga trafikanti gjatë kryerjes së krimit në rrugë dhe prandaj nga organet e ndjekjes dhe nga organet e jurisprudencës këta fëmijë e fitojnë statusin e kryerësit, e jo të VTQNJ. Djemtë e rinjtë shpeshherë përfshihen në kryerjen e veprave penale kundër pronës, siç janë vjedhjet, vjedhjet e rënda, ndërsa vajzat më së shpeshti bëjnë vjedhje xhepi dhe vjedhje nëpër dyqane (EUROPOL Public Information, 2018).

Edhe përkrah hyrjes në fuqi të Direktivës të BE 36/2011, ekziston mungesë e hulumtimit dhe ndërgjegjësimit për këtë formë të eksploatimit, ndërsa nga ana tjetër ka një numër shumë të vogël të rasteve të denoncuara në statistikën zyrtare, madje edhe shumë viktima të trajtuara gabimisht si kryerës. Vështirësitë e përcaktimit se bëhet fjalë për VTQNJ multiplikohen meqë trafikantët me qenie njerëzore i përshtatin aktivitetet e tyre kriminale me ambientin lokal social dhe juridik, me ç'rast në numrin më të madh të rasteve i anashkalojnë me sukses masat e identifikimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë. Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve si VTQNJ si imperativ imponohet ndërgjegjësimi, trajnimi dhe shpërndarja e informacioneve për problemin e eksploatimit kriminal të fëmijëve VTQNJ, kryesisht ndërmjet nëpunësve policorë (Anti-Slavery International, 2014).

Kjo formë e eksploatimit ekziston edhe në kuadër të veprës penale Trafikim me fëmijë nga neni 418-g të KP, ndërsa është inkorporuar me ndryshimet dhe plotësime e KP në vitin 2015. Në këtë mënyrë edhe fëmija VTQNJ e ka mbrojtjen e njëjtë si edhe personi i trafikuar i moshës madhore në kuptimin e mosdënimit për shkak të veprimeve që e krijojnë formën e eksploatimit:

Trafikimi me fëmijë (neni 418-g, paragrafi 1)

“(1) Ai i cili do të manipulojë fëmijë për kryerje të veprimeve seksuale ose do të mundësoj kryerje të veprimeve seksuale me fëmijë ose do të rekrutoj transportoj, transferoj, blej, shesë ose ofroj për shitje, furnizoj, siguroj, strehoj ose pranoj fëmijë për qëllim të eksploatimit përmes shfrytëzimit të tij në aktivitete seksuale për kompensim monetar ose për kompensim tjetër ose forma të tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë me detyrim, ose robëri, lypje ose eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj, skllavëri, martesë me detyrim, fertilizim me detyrim, adoptim të paligjshëm ose shtrëngim për pëlqim si ndërmjetësues të adoptoj fëmijë, transplantim i palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me burgim me më së paku tetë vjet.”

Fëmija viktimë ka pozitë të veçantë dhe sistem për mbrojtje konform Ligjit për drejtësi për fëmijë, i cili përcakton mënyra të veçanta të veprimit për shkak të ndihmës, mbështetjes, kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijës viktimë, shmangien e viktimizimit sekondar dhe reviktimizimit. Sidoqoftë kur do të konstatohet se fëmija është VTQNJ dhe se në mesin e formave të tjera të eksploatimit është trafikuar për kryerjen e aktiviteteve të ndaluara me ligj, duhet të interpretohet se gjendja e këtillë nënkupton bazë të veçantë për përfundimin e kundërligjshmërisë.

I akuzuari është shpallur për fajtor për veprën penale trafikim me qenie njerëzore meqë gjatë vitit 2007, për përfitim personal financiar e ka shfrytëzuar gjendjen e vështirë financiare të fëmijës VTQNJ në atë mënyrë që i ka dhënë para hua me obligim që të kthej një shumë më të lartë. Kur fëmija VTQNJ nuk ka pasur para të mjaftueshme për ta kthyer borxhin, i akuzuari e ka detyruar të merret me bixhoz dhe vjedhje. Gjatë procedurës është përcaktuar se viktima ka qenë inferiore në raport me të akuzuarin duke e pasur parasysh moshën e tij, papjekurinë emocionale dhe nivelin e ulët të inteligjencës. Megjithatë, viktima ka qenë e vetëdijshme se mund të ketë pasoja nëse nuk vepron në pajtim me urdhrat dhe udhëzimet e të akuzuarit për kryerjen e veprave penale.



Rast nga praktika

3.2. Eksploatimi i fëmijës së pashoqëruar të huaj

Reziqet lidhur me trafikimin me qenie njerëzore dhe eksploatimin e fëmijëve të cilët udhëtojnë të pashoqëruar, origjina e të cilëve është nga vendet e përfshira me konflikte, trazira ekonomike dhe sociale, në masë të konsiderueshme shënojnë rritje. Zgjerimi i krizës së migracionit në BE nga viti 2015 dhe përkeqësimi i gjendjeve sociale, veçanërisht në Afganistan, Irak, Pakistan dhe Siri, rezultoi me atë që me mijëra fëmijë (më së shpeshti djem të moshës 15 – 17 vjeçare) udhëtojnë drejt BE, shpeshherë duke i braktisur familjet e tyre me shpresë për një të ardhme më të mirë (EUROPOL Public Information, 2018).

Sipas sugjerimeve të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së, mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e fëmijëve të gjetur në konflikt ose krizë humanitare në masë të madhe janë joefikas dhe kanë efekt të vogël në parandalimin e gjendjes së pasigurt në të cilën gjenden këta fëmijë. Kampet e refugjatëve kanë kapacitete të kufizuara që të mundësojnë hapësira të specializuara dhe të veçanta për fëmijë. Vihet në dijeni se duhet të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave qytetare në mënyrë që të sigurohet identifikimi dhe mbrojtja e fëmijëve viktime dhe atyre që i janë ekspozuar rrezikut nga eksploatimi (<https://www.ohchr.org/>).

Në shtetin tonë, Ligji për të huaj nga viti 2018 parashikon mbrojtje të veçantë të fëmijës së pashoqëruar. Me fjalë të tjera, në përputhje me nenin 146, ekziston ndalim që fëmija të kthehet në shtetin e origjinës ose në shtet tjetër i cili pajtohet ta pranoj, derisa në atë shtet nuk i sigurohen kushte adekuate për pranim.

Nuk do të lejohet kthimi i fëmijës nëse kthimi i tij do të ishte në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve e Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese ose Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Fëmija i pashoqëruar do të qëndroj në lokacionin e propozuar nga kujdestari i caktuar nga QPS, ndërsa në raste të jashtëzakonshme mund të qëndroj në Qendrën e Pranimit të të Huajve me procedurë të përcaktuar me ligj.

SEKSIONI II

DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE DHE PASQYRA KOMPARATIVE**1. Nga cilat dokumente ndërkombëtare buron klauzola e mosdënimit të VTQNJ?**

Mbrojtja komplekse e VTQNJ, e parashikuar me Konventat dhe dokumentet e tjera të OKB, Këshilli i Evropës (KiE) dhe BE si krim i rëndë ndërkombëtar, implikon obligim për shtetet nga njëra anë t'i inkriminojnë veprimet e vendosjes së personave në gjendje të mjetit për eksploatim në aktivitete kriminale dhe në aktivitete të tjera të kundërligjshme, dhe nga ana tjetër t'i mbrojnë viktimat nga viktimizimi i sërishëm për shkak të involvimit të tyre të detyrueshëm nga ana e kryerësve të trafikimit të veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme, domosdoshmërisht të lidhura me statusin e tyre të viktimit, dhe nga aspekti i ndjekjes penale ose kundërvajtëse dhe zbatimit të dënimeve për veprat e këtilla.

Në këtë qasje, e cila bazohet në idenë e pajtimit midis, nga njëra anë, kërkesës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe nga ana tjetër interesit publik për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe parimit të ligjshmërisë si parim themelor i luftës kundër krimit, konventave kryesore ndërkombëtare për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore inkorporojnë në sistemin e kategorizimit të së drejtës një parim të ri i cili kërkon shpjegim teorik, jetësim legjislativ dhe përpilim të udhëzimeve praktike të zbatimit – parimi i mosdënimit të VTQNJ për veprat e kryera në cilësinë e viktimit. Ky parim në mënyrë eksplicite është sanksionuar në Konventën e KiE për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore nga viti 2005 (neni 4-a) dhe Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga viti 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave dhe zëvendësimin e Vendimit Kua-dër të Këshillit nga viti 2002.

Protokolli i OKB-së për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht me gra dhe fëmijë ndaj Konventës së Palermo-s për krimin e organizuar nga viti 2000 nuk përmban një dispozitë të atillë eksplicite, e që është befasuese, meqë Protokollin i njëkohshëm i OKB-së për kontrabandë me migrantë në mënyrë eksplicite e parashikon parimin e mosdënimit të migrantëve. Megjithatë, gjatë interpretimit të tij, Komisioni për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së dhe *ad hoc* Komiteti i tij për trajtimin e Konventës potencojnë se:

“Personat e trafikuar shpesh ndiqen për vepra të cilat ndërlidhen me statusin e tyre të viktimit, siç është shkelja e akteve normative për imigracion, prostitucion etj., me ç'rast shtetet thirren të përmbahen nga ndjekja për vepra të këtilla të ndërlidhura me statusin e viktimit”

Për herë të parë një dispozitë për mosdënim është parashikuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nga viti 2001 për trafikimin e grave dhe fëmijëve, me të cilën shtetet thirren ta inkriminojnë trafikimin me gra dhe fëmijë, duke siguruar që viktimat të mos dënohen (*General Assembly Resolution on Traffic in Women and Girls, A/RES/55/67, 31.January 2001*).

Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së (*UNHCHR*) në Parimet dhe Udhëzimet e tij të Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore (*Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking, Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights to the Economic and Social Council, E/2002/68/Add.1, 20. May 2002., p. 3*), në mënyrë të veçantë e apostrofon si vijon:

“Personat e trafikuar nuk duhet të arrestohen, akuzohen dhe dënohen për paligjshmërinë e hyrjes ose qëndrimit të tyre në vendin e transitit ose destinacionit, ose për përfshirjen e tyre në aktivitete të kundërligjshme në rastet kur një gjë e këtillë është pasojë e drejtpërdrejtë e statusit të tyre të personave të trafikuar”

OSBE në Plan Veprimin e saj për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore nga viti 2005 i OSBE-së po ashtu rekomandoi të përjashtohet dënimi i viktimave për vepra të cilat janë si pasojë e drejtpërdrejt e pozitës së tyre të vikimave (*OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Persons, Decision 557, Revision 1, 7 July 2005*).

Sa i përket statusit të fëmijës VTQNJ doemos duhet të merren parasysh garancitë të cilat çdo fëmije ia ofron Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokollin Fakultativ ndaj KDF që ka të bëjë me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve. Në përputhje me këto dokumente të OKB-së, shtetet e kanë për detyrë të sigurojnë veprim i cili është në interesin më të mirë të fëmijës, përkatësisht në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijën, me rëndësi primare duhet të jenë interesat e fëmijës. Shteti duhet t'i investoj të gjitha kapacitetet institucionale dhe personale në mënyrë që ta mbroj fëmijën nga të gjitha format e eksploatimit të dëmshme për të, ndërsa në këtë kuadër është detyrimi që të ndërmerren masa përkatëse nacionale, bilaterale dhe multilaterale, mes tjerash, për parandalimin e trafikimit me fëmijë për cilindo qoftë qëllim dhe në cilëndo qoftë formë. Në përputhje me Protokollin Fakultativ me shitje të fëmijës nënkuptohet çdo veprim ose transaksion me ç'rast fëmija transferohet nga ndonjë person ose nga një grup i personave tek personi tjetër për kompensim monetar ose për ndonjë lloj tjetër të kompensimit. Në përputhje me Protokollin për parandalimin, pengimin dhe dënimin e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht me gra dhe fëmijë me të cilin plotësohet Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional (e ashtuquajtur Konventa e Palermos) është pranuar interpretimi ekstensiv i nocionit “trafikim me fëmijë”:

Me nocionin “trafikim me fëmijë” nënkuptohet rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i ndonjë fëmije me qëllim të eksploatimit, madje edhe në rastin kur nuk është shfrytëzuar asnjëra nga mënyrat e specifikuar në përkufizimin e nocionit “trafikim me qenie njerëzore” – kërcënim me përdorimin e forcës ose përdorimi i forcës apo forma tjera të detyrimit, rrëmbim, mashtrim, shpërdorim të pushtetit apo të pozitës së pafuqisë, dhënie ose marrje të pagesave ose përfitim për marrjen e pëlqimit nga ndonjë person i cili ka autoritet mbi një person tjetër me qëllim të eksploatimit.

Mbrojtja e fëmijës në mënyrë të posaçme është theksuar edhe në Komentin e përgjithshëm nr. 24 (2019) për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijë (General comment No 24 (2019) on children's rights in the child justice system), i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, në Gjenevë më datë 18.09.2019. Komiteti, në mënyrë eksplicite thekson se fëmijët mund të bëhen viktimë të formave të ndryshme të dhunës, siç është rekrutimi; stërvitja ushtarake, shfrytëzimi i fëmijëve në konflikte ushtarake dhe/ose vepra të terrorizimit, duke i përfshirë edhe sulmet vetëvrasëse, detyrimi të ekzekutojnë, të përdoren si mburojë e gjallë; kidnapim; shitje; trafikim; eksploatim seksual; martesë të fëmijëve; shfrytëzim gjatë transportit ose shitjes së drogës; ose eksploatim për kryerjen e detyrave të rrezikshme, siç është spiunazhi, përgjimi, roja në pikën e kontrollit, patrulla ose transportimi i pajisjes ushtarake.

Shpeshherë në rastet gjyqësore trafikanti aspak nuk e përdor forcën ose detyrimin dhe aspak nuk komunikon me VTQNJ, por me persona nga të cilët mund të merr pëlqim, persona këta të cilët kanë autoritet mbi VTQNJ.



...duke e shfrytëzuar pafuqinë e fëmijës VTQNJ e cila ka qenë nënë e fëmijës së vogël të cilin e ka nga bashkësia paraprake jashtëmartesore, ndërsa për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të familjes, nëna bashkë me birin e saj ia kanë shitur të akuzuarit vajzën e tyre përkatësisht motrën për 100 euro, i cili e ka blerë për të lidhur martesë me detyrim dhe ua ka dhënë gjysmën e shumës...

Konventa e KiE për aktivitete kundër trafikimit me qenie njerëzore nga viti 2005 përmban dispozitë për mosdënim (neni 26), sipas së cilës çdo shtet, në përputhje me parimet themelore të sistemit të vet juridik, duhet të parashikoj mundësi për mosdënimin e viktimave sa i përket involvimit të tyre në aktivitete të kundërligjshme, në masën në të cilën janë detyruar ta kryejnë të njëjtën. Në *Explanatory Report* është shpjeguar se shteti mund ta përmbush detyrimin e vet me parashikimin e zgjidhjeve në legjislacionin penal material ose procesual, ose në mënyrë tjetër (kundërvajtje administrative).

Direktiva e BE nr. 36 nga viti 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave nga trafikimi me qenie njerëzore (*Directive 2011/36/EU of the European Parliament and of the Council of 5 April 2011 on preventing and combating trafficking in human beings and protecting its victims, and replacing Council Framework Decision 2002/629/JHA*) parashikon udhëzime për shtetet anëtare të BE në lidhje me hapat e nevojshëm në inkriminimin e trafikimit dhe mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave. Ajo përmban edhe një dispozitë të veçantë (neni 8) që ka të bëjë me mosdënimin e VTQNJ:

“Shtetet anëtare në përputhje me parimet e tjera të sistemeve të tyre juridike, do të ndër marrin masa të nevojshme që të sigurojnë autorizime për organet e tyre të mos i ndjekin dhe të mos aplikojnë dënime ndaj VTQNJ në lidhje me involvimin e tyre në aktivitete kriminale në të cilat janë detyruar si pasojë e drejtpërdrejt e statusit të tyre të viktimave”

Si synim kryesor i cili arrihet me këtë dispozitë, Direktiva e thekson mbrojtjen e viktimave nga viktimizimi i sërishëm dhe stimulimin e bashkëpunimit të tyre në zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore. Pa një mbrojtje të këtillë, VTQNJ të cilat nuk janë identifikuar si të këtilla ose nuk iu garantohet mbrojtje nga dënimi i ekspozohen rrezikut që të përgjigjen për veprat e kryera me detyrim në shtetin e destinacionit, transitit ose në shtetin e tyre nacional, sipas parimeve të vlefshmërisë territoriale të së drejtës penale (territorialiteti, personaliteti aktiv ose universalizmi; v. *Explanatory report to the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings, 2005, CETS no. 197., par. 274.*).

Baza për qasjen e veçantë komplekse dhe krijimin e strategjive dhe politikave përkatëse për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore është pranimi i qasjes parimore se personat të cilët janë objekt i trafikimit dhe të cilatdo qoftë lloji të eksploatimit janë viktima, dhe jo kriminel, ndërsa *condition sine qua non* për njohjen e statusit të atyre të këtillë është ndryshim efektiv i parimit të mosdënimin (*Derencinović, (2014), 3*).

Parimi i mosdënimin nuk ka veprim absolut dhe nuk e përjashton përgjegjësinë dhe dënimin e VTQNJ për vepra në të cilat janë involvuar vullnetarisht si kryerës ose bashkëpjesëmarrës.

Kjo është rregulluar në mënyrë eksplicite me Direktivën e BE nr. 36 nga viti 2011, në Preambulën (14) të së cilës është parashikuar në mënyrë eksplicite se në përputhje me parimet themelore të sistemeve juridike të shteteve përkatëse nënshkruese, VTQNJ duhet të

mbrohen nga ndjekja penale ose dënimi për vepra të dënueshme, si për shembull, shfrytëzimi i falsifikimit të dokumenteve, ose për vepra konform ligjeve për prostitucion ose imigracion, ndërsa të cilët kanë qenë të shtrënguar si pasojë e drejtpërdrejtë e faktit se kanë qenë objekt i trafikimit, megjithatë mbrojtja ka të bëjë vetëm me vepra të cilat personi i ka kryer si VTQNJ, ndërsa nuk e nënkupton përjashtimin e plotë të ndjekjes penale për vepra të tjera.

Mbrojtja nga ndjekja dhe dënimi i veprimeve për të cilat kanë qenë të shtrënguar si pasojë e drejtpërdrejtë e faktit se kanë qenë objekt i trafikimit, nuk i përjashton procedurat gjyqësore ose dënimin për veprat të cilat personi përkatës i ka kryer ose në të cilat ka marrë pjesë me vullnetin e tij.

Së këtejmi, rol kryesor për zbatimin e parimit të mosdënimit ka pikërisht identifikimi i personit si VTQNJ dhe roli i tij i mundshëm si pjesëmarrës në ndonjë vepër penale, nga rastet e kryerjes vullnetare të veprës penale e cila nuk ndërlidhet me statusin e këtyre.

Konventa e KiE dhe Direktiva e BE nuk parashikojnë bazë të përgjithshme për mosdënimin e VTQNJ për cilëndo qoftë vepër, por, parashikojnë mundësi mosdënimi, konform parimeve të rregullimit juridik të çdo shteti, kur për një gjë të këtyre janë përmbushur kushtet e veçanta, para së gjithash nëse bëhet fjalë për vepra të kryera me “detyrim” (*Explanatory report to the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings, 2005, CETS no. 197*):

“Detyrimi” në kuptimin e gjerë specifikohet, si ndikim psikik mbi sjelljen e vullnetit të lirë të viktimës e që shkon përtej nxitjes (bindjes) së zakonshme të tjetrit dhe nënkupton shtrëngim të papërballueshëm psikologjik, forcë fizike ose kërcënim, rrëmbim, mashtrim, shpërdorim të pushtetit ose pozitës vulnere apo dhënie të pagesave ose dhënie të beneficioneve me qëllim të sigurimit të pëlqimit nga personi i cili është nën kontrollin e trafikantit.

Direktiva e BE nr. 36 nga viti 2011 në nenin 2 paragrafin 2 në mënyrë eksplicite e specifikon se çka nënkupton pozita e vulnerabilitetit në të cilin gjendet VTQNJ:

“Pozita e vulnerabilitetit” nënkupton situatë në të cilën personi i prekur nuk ka alternativë të mirëfilltë ose të pranueshme, përveçse t’i nënshtrohet keqpërdorimit.

Në këtë kuptim, pikë referimi e parimit të mosdënimit të viktimës është figura e “kryerësit të tërthortë” (*mittelbare Täterschaft*), sipas të cilës kryerësi i vërtetë i veprës është trafikanti, i cili ka kontroll mbi viktimën dhe komandon me vullnetin e saj, ndërsa viktima e ka rolin e objektit për kryerjen e veprës (teoria e “zotërimit” të veprës).

Me përfshirjen e nevojshme të këtyre aspekteve gjatë interpretimit të kuptimit, përfshirjes dhe konsekuencave nga parimi i pranuar i mosdënimit krijohet hapësirë për sqarime shtesë të bazës juridike dhe efekteve të saj – mosngritje të procedurës penale, mosakuzim ose moszbatim të dënimit.

Parashtrohet pyetja – a thua mosdënimi i viktimës është konsekuencë e përjashtimit të veprimit, kundërligjshmërisë, fajit ose dënimit si elemente të përgjithshme të nocionit të veprës penale; ose statusi i viktimës është pengesë procesuale për zhvillimin e procedurës penale; mosdënimi a ka të bëjë me cilëndo qoftë vepër, pavarësisht rëndësisë së saj, dhe vetëm me kusht që të ndërlidhet me statusin e viktimës; si të realizohet kërkesa për mosdënim konform parimeve të sistemit juridik nacional (parimi i ligjshmërisë, veprimit të bazave të përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë, fajit etj.); dhe cila është marrëdhënia e kësaj baze e mosdënimit dhe e bazave të tjera të përjashtimit të kundërligjshmërisë, fajit ose dënimit. Në këtë kontekst, është i kuptueshëm mosekzistimi i zgjidhjes uniformë në zbatimin e parimit të mosdënimit në legjislacionet penale bashkëkohore. Çdo shtet mund ta përmbush

obligimin e nenit 26 të Konventës Evropiane duke parashikuar baza materiale për mosdënim - përjashtim të kundërligjshmërisë, fajit ose dënimit, ose të bazave procedurale, siç është zbatimi i parimit të oportunitetit të ndjekjes së prokurorit publik.

Sa i përket precizimit të kushteve për zbatimin e standardit të deklaruar të ri të mosdënimit të VTQNJ në planin ndërkombëtar tanimë një kohë të gjatë punon një Grup Pune i veçantë për trafikimin me qenie njerëzore në Konferencën e shteteve nënshkruese të Konventës së OKB-së për trafikim me qenie njerëzore, i formuar në vitin 2009. Aktiviteti i tij në mënyrë të veçantë i përkushtohet përcaktimit të procedurave për identifikimin e VTQNJ me qëllim të mosdënimit të tyre dhe ofrimit të ndihmës, si dhe precizimit të veprave të kundërligjshme të kryera nga viktimat si pasojë e pozitës së tyre si persona të trafikuar, ose në rastet kur kanë qenë të detyruar të kryejnë vepra të atilla (s. *Schloenhardt, Markey-Towler, (2016), 26*). UN Conference of the Parties to the United Nations Convention against Transnational Organized Crime, Working Group on Trafficking in Persons, *Non-Punishment and Non-Prosecution of Victims of Trafficking in Persons: Administrative and Judicial approaches to Offences Committed in the Process of Such Trafficking*, UN Doc CTOC/COP/WG.4/2010/4 (9 December 2009), paras 10–11.

Përveç kësaj, nga UNODC (*United Nations Office on Drugs and Crime*), u hartua Projekt ligj kundër trafikimit me qenie njerëzore (Model Law against Trafficking in Persons) që t'u ndihmoj shteteve në zbatimin e Protokollit për parandalimin, luftimin dhe dënimin e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht me gra dhe fëmijë ndaj Konventës së Palermos (http://www.unodc.org/documents/humantrafficking/Model_Law_against_TIP.pdf). Neni 10 i Projektligjit përmban dispozitë të veçantë për mosdënim (neni 10): viktima e trafikimit me qenie njerëzore nuk do të konsiderohet se ka përgjegjësi penale ose administrative ose nuk do të dënohet për akte të kundërligjshme të kryera si pasojë e drejtpërdrejt e pozitës së tyre të personit të trafikuar dhe për veprat e imigracionit konform të drejtës nacionale; këto rregulla nuk kanë të bëjnë me vepra të natyrës serioze të përcaktuara me legjislacionin nacional.

Edhe në dokumente të tjera ndërkombëtare të cilat nënkuptojnë “soft law”- rekomandime, udhëzime, deklarata, rezoluta, shtetet thirren ta garantojnë mosdënimin e VTQNJ për vepra penale të kryera në cilësi të atillë, veçanërisht sa i përket hyrjes dhe qëndrimit të kundërligjshëm në shtet. Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në vitin 2002 përpiloi rekomandime për parimet dhe udhëzimet (*UNHCHR Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking*) në të cilat kërkohet (parimi 7) personat e trafikuar të mos arrestohen, ndiqen ose akuzohen për paligjshmëri gjatë hyrjes ose qëndrimit të tyre në shtetet e transitit ose destinacionit, ose për involvimin e tyre në aktivitete të kundërligjshme në masën në të cilën një gjë e këtillë është pasojë e drejtpërdrejt e pozitës së tyre si persona të trafikuar. Parimi 8 ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve viktima, të cilët nuk mund të jenë subjekte të procedurave penale ose sanksioneve për vepra që ndërliken me statusin e tyre të viktimit (s. *The United Nations High Commissioner for Human Rights Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking (included as an addendum to High Commissioner for Human Rights' report to the Economic and Social Council (E/2002/68/Add.1)*).

Nga dokumentet më të reja të OKB-së i rëndësishëm është edhe Protokollin ndaj Konventës për Punë me Detyrim nga viti 2014 (i Organizatës Ndërkombëtare të Punës), i cili në nenin 4 paragrafin 2 parashikon: çdo vend në përputhje me parimet themelore të sistemit juridik, do të ndërmarrë masa të nevojshme që t'i autorizojë organet kompetente të mos akuzojnë ose zbatojnë dënime për viktimat e punës me detyrim sa i përket involvimit të tyre në aktivitete të kundërligjshme të cilat kanë qenë të detyruar t'i kryejnë si pasojë e vartësisë së tyre për punë të detyruar.

Në konventat dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare të theksuara më lartë përdoren nocione të ndryshme – “moskriminalizim”, “mosndjekje” ose “mosdënim”, të cilat kanë implikime të ndryshme mbi fushën e zbatimit të parimit të mosdënimit të VTQNJ (s. *Jovanovic, (2017), 47*):

- **“moskriminalizimi”** – nocion shumë i gjerë, i cili e implikon përjashtimin e kundërligjshmërisë, dhe me këtë edhe të veprës penale, me të gjitha konsekuencat procesuale në vijim që e nënkuptojnë përjashtimin e procedurës penale;
- **“mosakuzimi”** – është përfshirë në nenin 8 të Direktivës nr. 36 nga viti 2011, lejon zhvillimin e procedurës dhe shfrytëzimin e argumenteve të viktimës si mbrojtje nga rasti në rast, e që krijon probleme tek shtetet në të cilat është pranuar parimi i legalitetit gjatë veprimit të prokurorisë publike;
- **“mosdënimi”** – është përfshirë në Konventën e KiE, neni 26, mund ta ketë kuptimin më të ngushtë dhe e implikon moszbatimin e dënimeve, por jo edhe zhvillimin e procedurës penale që mund të përfundoj me lirim nga dënimi ose me shqiptimin e masave tjera (dënim me kusht, dënim sekondar deportim nga vendi etj.).

Duhet të merret parasysh, përmes rrugës inverse, se është më së miri ky parim të emërtohet si parim i “mosdënimit”, meqë e thekson statusin final të VTQNJ

Është me rëndësi se VTQNJ nuk duhet të dënohet për veprat e kryera në cilësi të atillë, në kushte të veçanta të përcaktuara me Konventën e KiE dhe Direktivën (detyrim dhe vepra drejtpërdrejt të lidhura me statusin e saj). Së këtejmi, nuk është me rëndësi se a arrihet ky rezultat për shkak të përjashtimit të kundërligjshmërisë së veprës (moskriminalizim dhe mosakuzim, përkatësisht moszhvillim të procedurës, nëse vepra është kryer si mbrojtje e nevojshme ose si nevojë ekstreme), përjashtimit të fajit (identifikimi dhe përcaktimi i ekzistimit të detyrimit dhe lidhja direkte e veprës me statusin e viktimës) ose dënimi si bazë e posaçme personale për mosdënim (tejkalimi i nevojës ekstreme).

Dokumentet ndërkombëtare të trafikimit me qenie njerëzore nuk përmbajnë dispozita ose udhëzime më të përafërta për atë se – cilat vepra penale të kryera nga VTQNJ duhet të jenë pjesë e veprimit të parimit të mosdënimit, për shkak të diferencimit të saktë nga veprat për të cilat ata duhet të përgjigjen nëse i kanë kryer vullnetarisht. Së këtejmi, në mënyrë të saktë nuk është trajtuar kriteri i cili nga njëra anë ka të bëjë me “detyrimin” dhe nga ana tjetër me përcaktimin e veprave të cilat VTQNJ i kryejnë në kundërshtim me vullnetin e tyre, dhe veprave të tjera për të cilat do të duhej të përgjigjen. Shkaku për mosekzistimin e kriterëve më të përafërta është diversiteti i motiveve për shkak të të cilave viktimat japin pëlqim ose mund ta pranojnë statusin e viktimës (që nuk është relevante për ekzistimin e veprës trafikim me qenie njerëzore).

...pohimet e avokatëve të personave të akuzuar se gratë që kanë qenë VTQNJ kanë dhënë pëlqim të ofrojnë shërbime seksuale, madje ato kanë përfituar edhe financiarisht përmes ofrimit të shërbimeve të këtilla, nuk kanë rëndësi për ekzistimin e veprës penale trafikim me qenie njerëzore...



Rast nga praktika

Pëlqimi mund ta ketë si motiv edhe bindjen se në këtë mënyrë, me pranimin e këtij statusi viktimë mund të siguroj jetë më të mirë, ose nevoja jetësore, varfëria dhe mjerimi e kanë detyruar të jap pëlqim për eksploatim përmes prostitucionit ose për eksploatim ekonomik ose eksploatim tjetër, ose motiv vendimtar ka qenë diskriminimi racor ose ndonjë diskriminim tjetër në shtetin e origjinës, konflikti ushtarak, fatkeqësia natyrore, dhuna ndaj grave etj.

Gjendja e “nevojës jetësore” është ekuivalente me detyrimin psikologjik ose fizik dhe bëhet fjalë për rrethana të përafërta me “nevojën ekstreme”

Gjendjet e këtilla kanë diferenca nga motivet të cilat janë në shkallë më të ulët të nënshtrimit të nevojshëm: ofertë për përfitime më të mëdha, ofertë për jetë më të mirë dhe ngjashëm, në kushte kur viktima potenciale jeton në kushte tolerante të jetës që mund ta duroj, por nga të cilat nuk është e kënaqur. E gjitha kjo është e rëndësishme për identifikimin e ekzistimit të “pëlqimit” të VTQNJ, e cila nuk është element konstitutiv i inkriminimit, por ka rëndësi të madhe për zbatimin e standardit të mosdënimit të saj: një gjë është nëse ajo ka dhënë pëlqim të përfshihet në aktivitet të palejueshëm, siç është prostitucioni etj. meqë nuk ka kushte elementare për jetë ose arratiset nga dhuna në familje etj., ndërsa një gjë tjetër është nëse kjo për të është vetëm një mundësi e mirë për të përfituar më shumë dhe për të jetuar më mirë.

Zbatimi i parimit të mosdënimit ka një rol të rëndësishëm sa i përket mjetit që e fuqizon probabilitetin se viktima do të bashkëpunoj me organet e ndjekjes në zbulimin dhe dënimin e kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore, kundrejt pritshmërive të trafikantëve se ajo, nëse dënohet për veprat e kryera, do të jetë në anën e tyre dhe do t'i mbroj nga ndjekja penale. Duke e balancuar interesin e drejtësisë me interesin e mbrojtjes së VTQNJ, ai i pasqyron parimet përgjithësisht të pranuar të përgjegjësisë dhe bashkëpjesëmarrjes penale në sistemet bashkëkohore juridike penale dhe ka funksion praktik në drejtim të rritjes së efikasitetit të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, duke i mbrojtur viktimat e tij.

2. Cilat modele të mosdënimit të VTQNJ ekzistojnë në legjislacionet e huaja?

Në legjislacionet bashkëkohore penale janë inkorporuar këto modele të mosdënimit të VTQNJ (B. Munivrana, Dragičević, Maršavelski, (2016), 999; Schloenhardt, Markey-Towler, (2016), 36):

→ Modeli i “detyrimit”

- viktima nuk përgjigjet për veprën e kryer nën shtrëngim
- nga aspekti legjislativ rregullohet me përjashtimin e dënimit me dispozitë të përgjithshme në Kodin Penal, sipas së cilës forca absolute e përjashton kundërligjshmërinë e veprës, ndërsa shtrëngimi psikik e përjashton fajin, nëse janë përmbushur kushtet e ekzistimit të nevojës ekstreme;

→ “modeli kauzal”

- viktima nuk përgjigjet për veprën e cila në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet dhe rezulton nga statusi i saj si viktimë
- realizohet me qasjen kauzale, përkatësisht me parashikimin e bazës së posaçme për mosdënim tek inkriminimi në trafikimin me qenie njerëzore;

→ disa autorë krahas modeleve të përmendura e diferencojnë edhe të ashtuquajturin “model i kombinuar”

- i përjashton edhe veprat e viktimës të kryera me detyrim dhe veprat të cilat rezultojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ose janë shkaktuar nga pozita e saj si viktimë
- nga aspekti legjislativ rregullohet me dispozitë të posaçme ky inkriminimi i trafikimit me qenie njerëzore, e cila i parashikon që të dyja bazat e mosdënimit; a) vepra të jetë kryer me detyrim, ose b) të rezultojë nga pozita e kryerësit si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore.

Konventa e KiE në mënyrë të veçantë e thekson modelin e “detyrimit” (neni 26), i cili e kufizon mosdënimin e veprave për kryerjen e të cilave viktima është detyruar, përkatësisht ka kryer vepër nën presionin e trafikantit e që e kufizon lirinë e saj të zgjedhjes dhe plotësisht ose në masë më të madhe e përjashton vendimin dhe veprimin e saj autonom. Ky model është restriktiv dhe nuk siguron mbrojtje të mjaftueshme për viktimen kur bëhet fjalë për veprime të tjera me të cilat paralizohet liria e saj e zgjedhjes dhe vullneti i lirë (mashttrim, shfrytëzimi i gjendjes së pafuqisë, vartësisë etj.). Nga ana tjetër, me formulën e “detyrimit” në masë të konsiderueshme nuk justifikohen veprat “liruese” të cilat viktima i kryen sipas vullnetit të lirë të saj (sulm ndaj trafikantit, vjedhje të mjetit transportues për t’u arratisur etj.).

Direktiva e BE, e përfshinë modelin e detyrimit dhe modelin kauzal (neni 8, vepra për të cilat viktimat “kanë qenë të detyruara si pasojë e drejtpërdrejt e statusit të tyre të viktima-ve”). Kjo është një dispozitë restriktive e cila i përfshinë të dyja kushtet: VTQNJ nuk dënohet nëse është detyruar të bëjë aktivitet kriminal, por vetëm aktivitet të atillë që është si pasojë e drejtpërdrejt e statusit të saj si viktimë.

Modeli i detyrimit mbështetet mbi mësimin e nevojës ekstreme si element negativ i veprës, përkatësisht i bazës për përjashtimin e kundërligjshmërisë së saj ose fajit të kryerësit.

Në rast të ekzistimit të detyrimit përjashtohet vepra penale, ndërsa me këtë edhe dënimi i viktimës, me atë që gjatë intensitetit më të ulët të detyrimit mund të bëhet fjalë për vepër të kundërligjshme ose të kamufluar, por viktima të lirohet nga dënimi. Përjashtim të përgjegjësisë dhe dënimit mund të kemi nëse krimi i shkaktuar me veprimin e VTQNJ është më i vogël se krimi që ajo medoemos është dashur ta pësojë nëse nuk e ndërmerre atë veprim (pra, nëse viktima është detyruar të falsifikoj dokumente, por jo edhe nëse kryen vrasje që të shpëtoj nga veprimi përçmues). Ky model vështirë mund të zbatohet nëse viktima është në pozitë përlulësie, robërie ose skllavërie jo me shtrëngim ose kërcënim, por, për shembull, me mashttrim, përveç nëse me mashttrimin marrëdhënia e krijuar e skllavërisë shndërrohet në detyrim dhe kufizim të lirisë së saj të zgjedhjes.

Modeli kauzal si pikë referimi e ka idenë se vet pozita e VTQNJ është shkak për veprën të cilën e ka kryer ndërkaq në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet me statusin e saj të viktimës.

Sipas rregullit, ky model nënkupton edhe dispozita shtesë të cilat parashikojnë kushte të posaçme për përjashtimin e përgjegjësisë penale dhe ndjekjes. Si kushte tipike në legjislacione të caktuara theksohen si vijon: vepra të nënkuptoj kryerje të urdhrat të trafikantit; të bëhet fjalë për grupe të caktuara të veprave (vepra statusore, vepra në lidhje me dokumente personale) ose vepra të specifikuar në mënyrë taksative (prostitucion, kalimi ilegal i kufirit, punë e jashtëligjshme, evazion tatimor, skllavëri, punë me detyrim, lypje, tregti e kundërligjshme, keqpërdorim të narkotikeve etj.); të bëhet fjalë për rast të rëndë të trafikimit me qenie njerëzore i cili përfshin dhunë, detyrim ose shpërdorim të detyrës; viktima të ketë kontribuar për identifikimin, zbulimin ose kapjen e kryerësit të trafikimit; ose të bëhet fjalë për fëmijë. Diversiteti i kriterëve shpie në mosunifikimin e praktikës së shteteve, që kontribuon, gjatë qasjes restriktive, të dobësohen efektet e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, meqë gjatë kushteve restriktive të mosdënimin të viktimës kryerësit e trafikimit veprojnë me siguri më të madhe se viktima nuk do t’i denoncoj dhe nuk do të bashkëpunoj me drejtësinë.

Analiza komparative e dhjetë legjislacioneve penale e hartuar nga GRETA (*Group of Experts on Action against Trafficking in Human Beings*) pasqyron dallime të rëndësishme të cilat krijojnë probleme të shumta praktike në rastet e transitimit të viktimës nga një shtet në shtet tjetër (b. *Derenčinović*, (2014), 10).

Legjislacionet shpeshherë përdorin modele të kombinuara, kështu që në disa prej tyre prevalon modeli i “shtrëngimit”, ndërsa në disa të tjerë modeli i “kauzalitetit”, por edhe me elemente të modelit tjetër.

Shtetet në të cilat prevalon modeli i “detyrimit” janë Austria, Kroacia, Danimarka, Shqipëria, Sllovakia dhe Bullgaria. KP i Austrisë (neni 10) përmban zgjidhje për nevojën ekstreme si bazë për lirim nga akuza, me atë që përveç elementeve të rrezikut që evitohen duke shkaktuar një pasojë të dëmshme e cila nuk është disproporcionalisht më e rëndë nga ajo që kërcënohet, përgjegjësia e viktimës përjashtohet edhe pse “në pozitën në të cilën gjendej nuk është mundur të pritej një sjellje e ndryshme nga tjetri për mbrojtjen e vlerave juridike”.

KP i Kroacisë e përmban institutin e përgjithshëm të forcës ose kërcënimit si bazë për përjashtimin e veprës penale (neni 31): nuk ka vepër penale kur kryerësi ka vepruar nën ndikimin e forcës së paevitueshme (paragrafi 1). Nëse kryerësi ka bërë vepër penale nën ndikimin e forcës të cilën ka mundur ta kundërshtoj ose nën ndikimin e kërcënimit, do të zbatohet dispozita e nenit 30 (nevojë ekstreme), duke e kuptuar forcën ose kërcënimin si rrezik evident (paragrafi 2). Në rastin e parë të forcës absolute është përjashtuar subjekti i veprës ndërsa në rastin e dytë të forcës dhe kërcënimit kompulsiv - kundërligjshmëria. Së këtejmi, tek inkriminimi i trafikimit me qenie njerëzore (neni 175) Kodi nuk parashikon bazë të posaçme për mosdënimin e viktimës, kështu që rastet e këtilla individuale duhet të gjykohen në kontekstin e dispozitës së përgjithshme të KP (neni 31) për forcën dhe kërcënimin.

Legjislacioni shqiptar, e ka sanksionuar zgjidhjen e përgjithshme përmes dispozitës për nevojën ekstreme në KP (neni 20), ndërsa në dispozitën për trafikim me qenie njerëzore (neni 110-a), nuk parashikon dispozitë të posaçme për mosdënimin e viktimës. Me zgjidhjen procesuale të parimit të oportunitetit, prokurori publik është autorizuar të mos hap procedurë kundër viktimës për vepra që ndërlidhen me trafikim, për shkak të mosekzistimit të fajit tek viktima e cila është në pozitë vartësie. Një zgjidhje e këtillë e përgjithshme është sanksionuar edhe në legjislacionin bullgar (KP neni 13 paragrafi 1): nuk është i rrezikshëm ndaj shoqërisë veprimi i kryer nga personi në nevojë ekstreme, për shkak të shpëtimit të interesave shtetërore ose shoqërore, të mirave personale ose të mirave të tjera pronësore nga rreziku i drejtpërdrejt, të cilin kryerësi nuk ka mundur ta evitoj në mënyrë tjetër, nëse lëndimet e shkaktuara me veprimin janë më pak të rëndësishme sesa lëndimet e parandaluara.

Zgjidhje specifike parashikon KP danez, sipas të cilit (neni 86 paragrafi 6) si rrethanë lehtësuese duhet të merret kryerja e veprës nën ndikimin e forcës, mashtrimit ose shfrytëzimit të moshës së re të kryerësit, vështirësitë e rëndësishme financiare ose personale, papërgjegjësia ose gjendja e vartësisë. Edhe legjislacioni sllovak parashikon zgjidhje të përgjithshme - viktima mund të lirohet nga përgjegjësia nëse ka kryer vepër me shtrëngim ose në gjendje të vartësisë ose të subordinimit të trafikantit.

Kjo zgjidhje nuk mund të pranohet si zgjidhje e përgjithshme dhe si bazë e mjaftueshme për justifikimin e mosdënit të VTQNJ, meqë ka të bëjë vetëm me nocionet e forcës absolute ose kompulsive (relative) ose kërcënimit me forcë, kështu që nuk i përfshin rastet në të cilat viktima është manipuluar që të kryej një veprim të caktuar të parashikuar si vepër penale në mënyrë tjetër, me të cilën kufizohet liria e tij e vendosjes: vartësi psikologjike, duke e çuar në një gjendje të ngjashme me skllavërinë përmes shantazhit (sekuestrim të dokumenteve të udhëtimit), mashtrimit (se do të lirohet).

Modeli kauzal i lidhjes shkak - pasojë është sanksionuar në legjislacionin e Qipros në Ligjin 87 për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, në të cilin (neni 42) është parashikuar se viktima nuk do të ndiqet për veprën e kryer të ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me statusin e saj të VTQNJ, nëse është kryer me forcë, kërcënim ose shpërdorimin e detyrës së tjetrit: këto kërkesa nuk kanë të bëjnë me fëmijën si viktima. Sa u përket viktimave të cilat janë shtetas të vendeve të treta, ato nuk do të ndiqen për veprën e cila në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet me statusin e tyre të viktimave, veçanërisht nëse veprat janë kryer si rezultat i

hyrjes, qëndrimit ose punësimit të tyre jolegal. Ky ligj parashikon se nëse VTQNJ ndiqen për vepra të kryera derisa kanë qenë subjekte të trafikimit (në situatë kur viktimë nuk është identifikuar si e këtillë para akuzës, ose nëse ajo mbrohet se ka pasur status të këtillë gjatë kohës së gjyqimit), ka mundësi të mbrohet me atë se vepra është kryer me kërcënim, me forcë ose shtrëngim ose me formë tjetër të kërcënimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, shpërdorimit të detyrës ose shfrytëzimit të pozitës së saj vulnerable.

Një zgjidhje të veçantë njih Ligji kundër trafikimit me qenie njerëzore i Rumanisë (neni 20), sipas të cilit nuk dënohet viktimë që si rezultat i shfrytëzimit të saj ka kryer vepër të prostitucionit, lypjes, kalimit kontrabandë të kufirit ose implantim të organeve, indeve ose qelizave. Për vepra të tjera, siç është falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit ose i dokumenteve të identitetit e nxitur nga trafikanti, mund të zbatohen dispozitat e nevojës ekstreme (KP neni 10 dhe 46). Ligji i Gjeorgjisë kundër trafikimit me qenie njerëzore e përjashton dënimin (neni 15) për vepra të përcaktuara në mënyrë eksplicite në KP dhe Ligjin për kundërvajtje (falsifikim të dokumenteve, hyrje kontrabandë në vend, mosparaqitja e vendbanimit etj.).

Nuk është përjashtuar përgjegjësia penale e VTQNJ si kryerës i krimit ndërkombëtar: sipas Statutit të KNL (neni 33), kryerja e veprave në kompetencë të gjykatës me urdhër të Qeverisë ose të personit të autorizuar në asnjë rast nuk liron nga përgjegjësia nëse bëhet fjalë për vepra gjenocidi ose krime kundër njerëzimit.

Nga analiza komparative madje (qoftë edhe sipërfaqësore) rezulton konkluzioni se nuk ekziston model universal sa i përket realizimit konsekuent të parimit të mosdënimit të VTQNJ madje edhe në planin ndërkombëtar ose nacional nuk janë mbyllur të gjitha presupozimet për zgjidhje konsistente, të cilat do të nënkuptonin edhe mbrojtje efikase të të drejtave të tyre dhe të interesit publik për parandalimin e kriminalitetit. Harmonizimi i këtyre interesave nuk mund të realizohet me qëndrim të njëanshëm ose me papërgjegjësi absolute dhe mosdënim të VTQNJ për cilëndo qoftë vepër të kryer, ose me dënimin e tyre absolut për çdo vepër të kryer, për të cilat nuk përjashtohet kundërligjshmëria ose faji sipas instituteve të përgjithshme të së drejtës penale.

Nga pasqyra komparative rezulton perceptimi se zgjidhja më e mirë është kombinimi i dispozitave nga pjesa e përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me përjashtimin e kundërligjshmërisë ose fajit (nevoja ekstreme) dhe inkorporimi i dispozitës së veçantë në pjesën e veçantë të KP, me të cilën përcaktohen kushtet e mosdënimit të viktimës për vepra të caktuara penale, madje e cila ka veprim në bazë personale për përjashtimin e dënimit

Ekzistimi i bazave të ndryshme ka konsekuenca të ndryshme juridike: dispozitat e përgjithshme e përjashtojnë ekzistimin e veprës penale të viktimës dhe e përjashtojnë përgjegjësinë edhe të pjesëmarrësve të tjerë në atë vepër, ndërsa baza personale e mosdënimit të viktimës, sipas rregullit, nuk e përjashton përgjegjësinë e bashkëpjesëmarrësve të saj, përveç në rastet e nevojës për ndihmë në të cilat edhe sa u përket atyre mund të zbatohen bazat e përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë (mbrojtje e nevojshme dhe nevojë ekstreme). Sa i përket konsistencës së zbatimit të parimit të mosdënimit të VTQNJ mund të kontribuoj edhe aprovimi i parimit të oportunitetit të ndjekjes, i cili mund t'i përfshij rastet kufitare të gjendjes së viktimës, siç është intensiteti më i ulët i vartësisë, lajthitja dhe ngjashëm, ose nevoja për trajtim më të butë të bashkëpjesëmarrësve të saj gjatë kryerjes së veprës.

SEKSIONI III

SI TË INTERPRETOHEN DHE ZBATOHET DISPOZITAT E KP**1. Identifikimi i viktimës si aktivitet primar**

Udhëzimet për zbatimin efektiv të klauzolës së mosdënimit të viktimave u referohen informatave se në procesin e identifikimit të VTQNJ janë përfshirë specialistë të më shumë fushave, meqë ky proces ka aspekte sociale, juridike, psikologjike, ndërkombëtare si dhe aspekte të tjera, me ç'rast gjatë hartimit të tyre, në mënyrë të veçantë, janë analizuar udhëzimet Rajonale të ODIHR, të hartuara konform konventave dhe dokumenteve ndërkombëtare: Protokollin për Parandalimin, Luftimin dhe Dënimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, posaçërisht me gra dhe fëmijë, me të cilin plotësohet Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Palermo 2000); Konventa për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të KiE (Varshavë 2005); Udhëzime dhe parime të rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin me qenie njerëzore të OKB-së ECOSOC (2002); Mekanizma nacional të referimit, Përpjekje të bashkuara për mbrojtjen e të drejtave të VTQNJ – Manual praktik, OSBE/ODIHR, Varshavë (2004); Udhëzime për zhvillimin e mekanizmit transnacional për referimin e VTQNJ: Evropa Juglindore, IMCPD, Vjenë (2009); Trafikimi me qenie njerëzore: identifikimi i viktimave potenciale dhe të presupozuara, qasja e komunitetit lokal, OSBE, Vjenë (2011) dhe dokumente të tjera të OSBE dhe të autoriteteve tjera ndërkombëtare.

Udhëzimet e rekomanduara rajonale fokusohen mbi:

- konceptualizimin e nocionit “identifikimi i VTQNJ” – qëllime, qasje, mekanizma dhe parime;
- lidhjen e identifikimit me përkufizimin e trafikimit me qenie njerëzore;
- procesin e identifikimit – fazat dhe metodat e përdorura;
- indikatorët e identifikimit të viktimave të presupozuara.

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, (Neni 10), është e domosdoshme shtetet t'i ofrojnë mbrojtje personit për të cilin besojnë se është VTQNJ, dhe jo dëbimin e tij në shtetin e banimit.

Nëse organet kompetente kanë baza të arsyeshme që të besojnë se ndonjë person është VTQNJ, çdo shtet e ka për detyrë të siguroj që ai person të mos dëbohet nga territori i tij deri në përfundimin e procesit të identifikimit të tij

Konventa e Këshillit të Evropës e imponon obligimin e shtetit të siguroj që gjatë procesit të identifikimit të marrin pjesë nëpunës shtetërorë të trajnuar për një gjë të këtillë – pjesëtarë të policisë, inspektorë të punës, dogana, shërbimet e imigracionit, ambasada dhe konsullata.

Nëse ekziston dyshimi se ndonjë person është VTQNJ atëherë shteti e ka për detyrë ta mbaj në territorin e tij derisa të identifikohet se a është viktimë dhe a ka marrë pjesë në kryerjen e ndonjë vepre.

Kur mosha e viktimës është e panjohur dhe ka arsye të besohet se është fëmijë, duhet të supozohet se është fëmijë dhe t'i nënshtrohet masave të veçanta të mbrojtjes (Konventa e KiE; Direktiva e BE, neni13)

Obligimi i shtetit për identifikimin e VTQNJ e përfshin presupozimin e procedurave përkatëse të identifikimit të VTQNJ dhe koordinimin e institucioneve të ndryshme që kanë kontakt me rastet e trafikimit me qenie njerëzore (*Regionalne smernice, (s.a.), 13*).

Në përputhje me GJEDNJ, shtetet e kanë për detyrë të ndërmarrin veprime në kohë dhe të domosdoshme me të cilat do të hetohet rasti, do të zbatohet hetim efektiv dhe do të vlerësohet se a ka ekzistuar punë me detyrim, robëri, skllavëri apo jo.



**T.I. and Others
v. Greece**
**Application no.
40311/10**
**Judgment
18 July 2019**

Në këtë rast, tre shtetas rus pohonin se kanë qenë VTQNJ për shkak të prostitucionit dhe kanë theksuar se hetimi ka qenë joadekuat dhe se ka pasur mangësi gjatë hetimit dhe procedurës gjyqësore.

GJEDNJ konstatoi se është shkelur nenin 4 i KEDNJ (ndalimi i skllavërisë dhe punës me detyrim), duke konstatuar se korniza juridike sipas së cilës është realizuar procedura nuk ka qenë efektive dhe e mjaftueshme as për dënimin e trafikantëve me qenie njerëzore dhe as për sigurimin e parandalimit efikas të trafikimit me qenie njerëzore. GJEDNJ veçanërisht e vuri në dukje atë se në këtë rast organet kompetente nuk kanë vepruar në nivelin e nevojshëm të përkushtimit dhe se ankimesit nuk kanë qenë të përfshirë në procesin e hetimit në përmasat që kërkohen konform aspekteve procedurale të nenit 4 nga KEDNJ.

Identifikimi i viktimës e supozon përcaktimin e elementëve objektivë dhe subjektivë. Në aspektin objektiv, identifikimi supozon ekzistim të veprimit të kryerësit të veprës trafikim – dhunë, shtrëngim, mashtrim etj., e që për pasojë e kanë vendosjen e personit ndaj të cilit janë kryer në gjendje të përlësisë, varësisë, bindjes ose në gjendje tjetër në të cilën vullneti i lirë i tij është kufizuar ose përjashtuar. Në kuptimin subjektiv statusi i viktimës presupozon ekzistimin e vetëdijes tek ai person se ndaj tij janë kryer veprime të atilla dhe se të njëjtat kanë veprim determinues në lidhje me veprimin dhe vendimmarrjen e tij.

Zbatimi efikas i modelit legjislativ të mosdënimit të VTQNJ e implikon nevojën e krijimit të sistemit të strukturuar funksional të mekanizmave për identifikimin dhe trajtimin e viktimave, të cilat i realizojnë detyrat e tyre përmes bashkëpunimit të koordinuar dhe të formalizuar në më shumë nivele

Sipas përvojave të vendeve të rajonit, ato janë vendosur në një rrafsh më të gjerë, në të cilën krijohen politika dhe koordinohen aktivitetet e institucioneve kompetente – Trup nacional për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, i cili i koordinon aktivitetet e institucioneve shtetërore dhe sektorit joqeveritar, trup strategjik – Këshill për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, i përbërë nga ministrat kompetentë i themeluar me Vendimin e Qeverisë, trup operativ - koordinator për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të ministrive dhe trupave ndërkombëtare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, trupa policorë (drejtoria për luftimin e krimit të organizuar, policia kufitare, zyra nacionale e Interpol, dogana dhe trupa të specializuara policore), prokuroria publike dhe gjykatat dhe organizata të specializuara qeveritare dhe joqeveritare, organizata nacionale dhe ndërkombëtare-qendra pranimi, këshillimore, OSBE dhe IOM etj. (Krahasime të mekanizmave në Serbi, *Jovanović, Savić, (2008), 10*).



Me rëndësi të veçantë për funksionimin e gjithë mekanizmit dhe kufizimin e kompetencave të trupave të caktuar është:

- Së pari, identifikimi i VTQNJ dhe përcaktimi i formës së eksploatimit; dhe
- Së dyti, përcaktimi i pjesëmarrjes së saj në kryerjen e veprës penale ose kundërvajtjes dhe të përmbushjes së kushteve për mosdënimin e saj e që për pasojë është mosngritja e procedurës penale ose kundërvajtëse, ndërprerja e procedurave ose miratimi i vendimit me lirim

Zbatimi i standardit të mosdënimin të VTQNJ realizohet përmes procesit i cili e përfshin:

- Identifikimin e VTQNJ, i determinuar nga forma e trafikimit, veprimit dhe mënyrës së kryerjes (shtrëngim, kërcënim, mashtrim etj.) dhe qëllimit të shfrytëzimit të saj (prostitucion, martesë me detyrim etj.);
- Identifikimin e veprës penale të kryer nga VTQNJ dhe lidhja e saj me statusin e viktimës;
- Identifikimi i bazave të mosdënimin të viktimës për veprën e kryer: forcë absolute, shtrëngim, kërcënim, mashtrim etj. përmes gradacionit të intensitetit të veprimeve mbi statusin e viktimës dhe sensibilitetit të saj mbi to përmes pasojave si përjashtim të vullnetit të lirë dhe zgjedhjes së sjelljes, frikës, varësisë etj.;
- Identifikimin e veprave të kryera nga viktima për të cilat nuk është përjashtuar dënimi i tyre dhe format e pjesëmarrjes në të njëjtat – kryerje ose bashkëpjesëmarrje.

Identifikimi fillon nga momenti (Konventa e KiE) kur organet kompetente kanë siguruar “bazë të arsyeshme të besojnë se një person është VTQNJ, megjithatë mbetet e paqartë se nga cili moment viktima e presupozuar e cila gjendet në pozitë vulnerable dhe për të cilën akoma nuk është konfirmuar se është viktimë, ka mbrojtje nga ndjekja ose akuza.

Hapi i parë në këtë operacion kompleks të konfirmimit – një person konkret a është viktimë e trafikimit, a ka kryer ndonjë veprë të caktuar ose a duhet të mbetet e padënuar për të njëjtën – është njohja dhe interpretimi i drejtë i dispozitave të KP.

Interpretimi i dispozitave të KP të cilat e përmbajnë përshkrimin ligjor të formave të caktuara të veprës trafikim me qenie njerëzore dhe dispozitat e ndërlidhura me to (për fajin, bashkëpjesëmarrjen etj.), ka rëndësi thelbësore në procesin e identifikimit të VTQNJ dhe në zbatimin e dispozitave për mosdënimin e tyre

Duke e pasur parasysh faktin se në procesin e identifikimit marrin pjesë autoritete të ndryshme – shërbimi i pranimit dhe ndihmës, përfaqësues të: policisë, qendrave për punë sociale, organizatave qytetare, të prokurorisë publike dhe nëse ka filluar procedura formale penale – gjykatave, nuk përjashtohet që gjatë interpretimeve të ndryshme dhe zbatimit të dispozitave juridiko-penale të ekzistojnë edhe kualifikime të ndryshme juridike formale. Së këtejmi, edhe nevoja për një qasje unike në justifikimin e kuptimit të dispozitave të caktuara juridike – penale, qëllimi i të cilave është ndërlidhja e aktiviteteve të këtyre institucioneve.

Njohja dhe të kuptuarit e këtyre veprimeve që e përbëjnë trafikimin me qenie njerëzore dhe trafikimin me fëmijë është parakusht kryesor për identifikimin e ndonjë veprimi të caktuar në ndonjë rast konkret e që do të rezultojë me identifikimin e personit si VTQNJ. Identifikimi i VTQNJ është i rëndësishëm për shkak të më shumë implikimeve të tjera fillimisht të ndërlidhura me vet VTQNJ, por edhe me trafikantin me qenie njerëzore dhe fëmijë.

VTQNJ nga organet kompetente duhet të pranoj mbrojtje, ndihmë dhe mbështetje të shpejtë, efektive dhe përkatëse, por njëkohësisht trafikanti me qenie njerëzore dhe fëmijë nuk guxon të mbetet i padënuar dhe ta shmang përgjegjësinë penale edhe atë jo vetëm për trafikimin me qenie njerëzore/ fëmijë por edhe për veprat penale që i ka kryer VTQNJ në dobi të trafikantit, me detyrimin e tij, ndërsa në gjendje vulnerable

Në përputhje me PSO, identifikimi nënkupton tërësi procedurash dhe masash të institucioneve kompetente për veprim, të cilat në bazë të rrethanave, në të cilat është zbuluar personi, fokusohen në grumbullimin e informacioneve dhe fakteve, përmes indikatorëve dhe intervistës së realizuar, me qëllim të përcaktimit të VTQNJ pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për person të rritur ose për fëmijë. Viktima potenciale e trafikimit me qenie njerëzore e nënkupton personin për të cilin në bazë të gjendjes vulnerable dhe rrethanave në të cilat gjendet, ekzistojnë indikatorë se është VTQNJ, megjithatë identifikimi i saj akoma nuk ka përfunduar ose personi refuzon të identifikohet si viktimë.

Çdoherë kur bëhet fjalë për fëmijë duhet të veprohet konform interesave më të mira të fëmijës në situatën konkrete, duke e marrë parasysh gjendjen në të cilën është fëmija, moshën e tij, pjekurinë, rreziqet ekzistuese dhe ngjashëm.

Identifikimi bëhet përmes indikatorëve të definuar, përkatësisht indikatorëve se një person është VTQNJ të cilët përmbajnë vlerësim të indikatorëve të ndryshëm të cilët, mes tjerash, ndërlidhen me rrethanat në të cilat është hasur (martesë me detyrim, lypje, prezencë në objekte hotelierike në cilësinë e hostesës, kërcimtares dhe ngjashëm), dokumentet të cilat i posedon ose nuk i posedon personi, njohjen e trajktores nëpër të cilën ka udhëtuar, mungesën e njohurisë se prej ku vjen dhe kush është destinacioni i fundit i tij, a e njuh dhe në ç'masë e njuh personin/personat që e shoqëron/jnë, përkatësisht me të cilët udhëton, pasigurinë në sjellje, pamjen e jashtme, pasigurinë, frikën nga komunikimi me nëpunësit policorë dhe ngjashëm.

Për ekzistimin e trafikimit nuk është e nevojshme që të jetë realizuar qëllimi i kryerësit, përkatësisht të ketë filluar eksploatimi

Që të ekzistoj trafikimi mjafton që tek kryerësi të ekzistoj qëllimi për eksploatim, të ekzistoj vetëdija dhe vullneti për realizimin e këtij qëllimi, e që është veçanërisht e rëndësishme për identifikimin e VTQNJ.

Si VTQNJ duhet të konsiderohet edhe personi i cili akoma nuk është eksploatuar dhe nuk e di se do të eksploatohet ose se ndaj tij ekziston një qëllim i këtitillë (kështu, veçanërisht, kur bëhet fjalë për raste të trafikimit përmes mashtrimit, premtimit etj.)

VTQNJ ndaj të cilës nuk ka filluar eksploatimi ka të drejtë të trajtohet si viktimë dhe t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje si çdo viktime tjetër të TQNJ.

Viktima është shitur nga tezza e saj, me qëllim që të lidhë martesë me trafikantin. Trafikanti i ka premtuar vajzës se do të dalin jashtë vendit dhe atje do të punojnë. Trafikanti ka siguruar dokument udhëtimi të falsifikuar për veten e tij dhe për fëmijën viktimë, por është zbuluar në kufi gjatë tentativës që ta fus viktimën në shtetin tonë.



Rast nga praktika

Zbatimi i dispozitës së mosdënimit problematizohet nëse personi, duke mos e ditur se është viktimë, merr pjesë në aktivitetin kriminal të kryerësit i cili e trafikon atë, meqë në këtë rast janë përmbushur elementët subjektivë të veprës të cilën e kryen ose në kryerjen e të cilës merr pjesë. Përveç pjesëmarrjes në veprat të cilat drejtpërsëdrejti ndërlidhen me trafikimin (falsifikim të dokumenteve, kalim kontrabandë i kufirit, mosparaqitje të qëndrimit etj.), përg-

jegjësia e “viktimës së pavetëdijshme” problematizohet nëse ajo kryen ndonjë vepër tjetër e cila ndërlihet me qëllimin e kryerësit të cilin ajo e ka të panjohur (prostitucion, lypje etj.), ose madje edhe është jashtë qëllimit të tij (vjedhje, përdhunim etj.).

Sa i përket përgjegjësisë së “viktimës së pavetëdijshme” duhet të zbatohet parimi i përgjegjësisë së presupozuar për shkak “kryerjes vullnetare” të veprës penale.

Përgjegjësia e presupozuar për shkak të “kryerjes vullnetare” të veprës penale tek e ashtuquajtura viktimë e pavetëdijshme nënkupton se mbi të bie barra e provës se është vënë në lajthitje dhe se është shfrytëzuar nga kryerësi i trafikimit si “instrument” për kryerjen e veprës, në mënyrë që të mund të zbatohet figura e kryerjes së tërthortë në rastet e lajthitjes së paevitueshme, por vetëm sa u përket veprave të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me trafikimin (falsifikim të dokumenteve etj.). Mosrealizimi i qëllimit (eksplotimit) e vështirëson dëshmimin, me të cilin qëllimi i kryerësit do të realizohet në rrethana objektive (përpunimi i dokumenteve, sigurimi i mjeteve për aktivitete të mëtutjeshme të jashtëligjshme, gjetjen e hapësirës për prostitucion etj.).

Në rastet kur identifikimi i viktimës është bërë sipas të gjithë indikatorëve në dispozicion, fakti që viktimë nuk është e vetëdijshme se është trafikuar nuk është pengesë për zbatimin e dispozitave përkatëse për ndihmën dhe mbështetjen e saj, përkatësisht për dënimin e trafikantit me qenie njerëzore/fëmijë. Personi VTQNJ edhe kur mohon se është mbajtur në kundërshtim me vullnetin e tij (për shkak të moshës nuk është në gjendje ta dijë se si duhet të veproj, se ajo që bëhet është e kundërligjshme dhe ngjashëm, veçanërisht nëse bëhet fjalë për familjarë të afërt, kështu që ka frikë se çka do të ndodhë me të pas kësaj).

Personi është VTQNJ edhe atëherë kur e mohon se është trafikuar dhe kur mendon se trafikanti i tij e ndihmon në jetë (viktimë e pavetëdijshme)

Në përputhje me Ligjin për të huaj nga viti 2018, nëse ekzistojnë baza dyshimi se i huaji është VTQNJ ose fëmijë i pashoqëruar do t’i lejohet qëndrimi i përkohshëm për shkaqe humanitare edhe pse nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me ligj për lejimin e qëndrimit të përkohshëm.

1.1. Hapat e veprimit dhe mbrojtjes së viktimës potenciale të TQNJ

Dyshimi. Situatat që mund të krijojnë dyshime për ekzistimin e trafikimit me qenie njerëzore/fëmijë janë të ndryshme varësisht nga ajo se a bëhet fjalë për trafikim të brendshëm ose për trafikim/kontrabandë me kalimin e kufirit shtetëror. Me kalimin e viteve gjithnjë e më shumë paraqiten raste të trafikimit të brendshëm me fëmijë e që karakterizohet me faktin se trafikimin e bën një person, dhe jo grup i organizuar, kështu që rastet zbulohen më me vështirësi, viktimë është fëmijë dhe nuk mund ta identifikoj rrezikun në të cilin gjendet, ka frikë ta denoncoj ose thjeshtë nuk din se si të veproj që të mbrohet. Është shumë vështirë të paraqitet dyshimi për trafikim me fëmijë, në rastin kur trafikantët janë persona të tyre të njohur, prindër, familjarë ose të njohur, ose persona që kanë lidhur ndonjë marrëveshje me prindërit të cilët kanë përfitime materiale nga trafikimi i fëmijës së tyre (lypje, punë me detyrim në lokale hotelierike, martesë me detyrim dhe ngjashëm). Duke i pasur parasysh këto situata, dyshimi mund të paraqitet tek përfaqësuesit e QPS kur kanë kontakte me familjen, ndërsa sapo të vërejnë aktivitete të pazakonshme në familje kur anëtarët e familjes nuk kanë përgjigje për atë se ku ndodhet ndonjë anëtarë i tyre (veçanërisht në familjet në të cilat për shkak të traditës zakonore martohen në moshë shumë të re), në rastet kur prindërit edhe pse të papunësuar kanë të ardhura të caktuara për jetë, kur fëmijët duken të lënë pas dore, pa përkujdesje, të frikësuar, nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor dhe ngjashëm. Dyshimi mund të shfaqet tek secili anëtar të stafit mobil, tek policia, prokuroria publike. Të gjithë ata e kanë për detyrë të përkushtojnë vëmendje në identifikimin e shenjave të para se një person ndoshta është VTQNJ, madje edhe atëherë kur

ai nuk është i vetëdijshëm për pozitën e këtillë dhe në mënyrë eksplicite kundërshton të pranoj se është trafikuar. Identifikimi duhet të bëhet varësisht nga sjellja e personit, raporti me personat e tjerë të familjes, me personat me të cilët jeton, kur përfiton ndërsa përfitimet nuk i ka në dispozicion, kur deklaron se ka borxh, kur në masë të pamjaftueshme i njeh personat me të cilët është në automobil ose me të cilët udhëton, (mos) njohja e rrugës të cilën e ka kaluar, mos pasja e njohurive se ku gjendet dhe kush është destinacioni i fundit, konfuzioni, frika, posedimi i dokumenteve të rrejshëm, ose mos pasje të dokumenteve, kur nuk është i paraqitur se punon në një lokal të caktuar, kur i ka skaduar leja e qëndrimit dhe ngjashëm. Të gjitha situatat e këtilla dhe të ngjashme me këto duhet të jenë sinjal, përkatësisht alarm, se duhet të kontrollohet gjendja e këtillë dhe të konfirmohet nëse dyshimi është i arsyeshëm ose jo.

Raportimi. Çdo përfaqësues i ekipit mobil, i organit social, policisë, organizatës joqeveritare ose Prokurorisë Publike, në rast të dyshimit pa prolongim duhet t'i shfrytëzojë kanalet e vendosura për raportim dhe koordinim – Mekanizmin Nacional për Referim, Njësinë Nacionale për Luftimin e Kontrabandës me Migrantë dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore (NJNLK-MTQNJ) ose Prokurorin Publik kompetent.

Vendosja. Personi për të cilin ka dyshime se ndoshta është VTQNJ nuk duhet të dërgohet në stacionin policor dhe të privohet nga liria, meqë në këtë mënyrë do të ndihet më shumë i rrezikuar, do të mungoj bashkëpunimi dhe do të viktimizohet në mënyrë sekondare. Personi që është viktimë potenciale e TQNJ duhet të vendoset në qendra përkatëse – Qendra për persona – viktimë të trafikimit me qenie njerëzore dhe viktimë të dhunës seksuale, Strehëza ose Qendra e Pranimi të të Huajve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional. Identifikimi, mbrojtja dhe kujdesi për VTQNJ mund të realizohet me sukses vetëm nëse ai realizohet në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional.

MNR funksionon nga viti 2005 dhe e ka për detyrë të siguroj identifikim adekuat, ndihmë dhe mbrojtje për VTQNJ, të bazuara në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht për fëmijë.

NJNLKMTQNJ është formuar me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit midis PPRM dhe MPB dhe mundëson reagim në kohë, të koordinuar dhe kompetent në rastet e formave të organizuara të kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore. Një praktikë e mirë në fushën e bashkëpunimit ndërinstitucional janë edhe të ashtuquajturit Ekipet mobile të cilat e mundësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin multisektorial midis MPB dhe MPPS dhe përfaqësuesve të organizatave qytetare dhe kanë rol proaktiv në procesin e veprimit në rast të dyshimit të viktimës potenciale të TQNJ.

2. Baza të përgjithshme për përjashtimin e kundërligjshmërisë së veprave të viktimës

Zbatimi i dispozitës për nevojën ekstreme (neni 10 KP) si bazë për përjashtimin e dënimit dhe kundërligjshmërisë të veprave të viktimës, përveç elementëve të tjerë objektiv-ekzistim të rrezikut evident i cili në mënyrë tjetër nuk ka mundur të evitohet dhe krimi i kryer të mos jetë më i rëndë se krimi që është kërcënuar, e supozon ekzistimin e elementit të veçantë subjektiv tek viktimë i cili sipas rregullit përbëhet nga vetëdija për gjendjen e nevojës ekstreme dhe nga vullneti për evitimin e rrezikut përmes kryerjes së veprimit të caktuar.

Ekziston përjashtim kur bëhet fjalë për format e trafikimit me qenie njerëzore, me ç'rast trafikanti e shfrytëzon paaftësinë mendore të viktimës (nëse bëhet fjalë për person të paparrshkueshëm, person i cili është nën ndikimin e narkozës, drogave dehëse etj.).

Në rastin kur trafikanti e shfrytëzon paaftësinë mendore të viktimës duhet të nënkuptohet se bëhet fjalë për kryerje të tërthortë, përkatësisht kryerje të veprës “përmes” viktimës si “instrument” për kryerjen e veprës (action libera in causa)

Sipas pikëpamjeve subjektive të pushtetit, nuk vepron në nevojë ekstreme ai i cili e cenon të mirën e tjetrit, duke mos e ditur rrezikun aktual që të shfrytëzohet si viktimë e trafikimit. Me të drejtë nënvizohet, se bazat e përjashtimit të kundërligjshmërisë mund të kenë veprim të atillë vetëm përmes prizmit të vetëdijes së kryerësit për ekzistimin e tyre, meqë vetëm me këtë presupozim relacioni objektiv ndërmjet normës prohibitore (ndaluese) dhe permissive (lejuese) e fiton mbulimin e nevojshëm subjektiv. Në kuptimin në të cilin duhet të ekzistoj faji, sa i përket esencës ligjore të veprës, duhet të ekzistoj edhe një qëndrim i caktuar subjektiv i kryerësit edhe për bazën e përjashtimit të tij. Bazimin subjektiv e vë në dukje edhe vet dispozita ligjore e nevojës ekstreme (neni 10 paragrafi 2 i KP), sipas së cilës vepra duhet të jetë kryer “me qëllim kryerësi ta shmang nga vetvetja ose nga dikush tjetër rrezikun evident të njëkohshëm”, që nga njëra anë e nënkupton orientimin objektiv, ndërsa nga ana tjetër orientimin subjektiv të veprimit drejt këtij qëllimi.

Kusht për përjashtimin e kundërligjshmërisë së veprës së viktimës është proporcioni i të mirave dhe përjashtimi i kundërligjshmërisë gjatë viktimizimit të së mirës më pak ose njëlloj të vlefshme, me qëllim të evitimit të rrezikut. Sipas teorisë së diferencimit (teori mikse, pluraliste), duhet të diferencohet situata e viktimizimit të së mirës më pak të vlefshme si bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë, nga situata e viktimizimit të të mirave njëlloj të vlefshme e që trajtohet si bazë për përjashtimin e fajit. Legjislacionet penale bashkëkohore kanë pozita të ndryshme: në shumicën prej tyre nevoja ekstreme është bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë në të dyja rastet; në disa legjislacione kjo është bazë e përgjithshme për përjashtimin e fajit (KP austriak dhe francez); në disa legjislacione viktimizimi i të mirës më pak të vlefshme e përjashton kundërligjshmërinë, ndërsa viktimizimi i të mirës ekuivalente e përjashton fajin (KP gjerman).

Sipas diksionit ligjor të nenit 10 paragrafi 2 të KP, sipas të cilit krimi i kryer nuk është më i madh se krimi që është kërcënuar, rezulton se KP e përjashton kundërligjshmërinë edhe në rastin kur bëhet fjalë për viktimizimin e të mirës ekuivalente

Përcaktimi i ligjvënësimit për këtë të ashtuquajtur **teori e unitetit**, ka disa konsekuenca në vijim:

- përjashtohet dënimi i bashkëpjesëmarrjes në veprën e kryer në nevojë ekstreme,
- lajthitja për ekzistimin e situatës së rrezikut trajtohet si lajthitje e vërtetë për rrethanat që e përjashtojnë kundërligjshmërinë (nevojë ekstreme putative);
- kundër veprimit të viktimës të ndërmarrë në nevojë ekstreme lejohet nevoja ekstreme, por jo edhe mbrojtja e nevojshme. Dallimi është i rëndësishëm, meqë kjo do të thotë se duhet të respektohet rregulli i rreptë i proporcionalitetit të të mirave, si dhe detyra e shpëtimit në mënyrë tjetër (mënjanimi para “sulmit”).

Veprimi i viktimës me të cilin parandalohet sulmi i trafikantit (mbrojtja e nevojshme, neni 9 KP) ose evitohet gjendja e rrezikshme në të cilën gjendet me përmbushjen e esencës ligjore të ndonjë veprë penale me viktimizimin e të mirave të tjera (nevoja ekstreme, neni 10 KP për shembull, dëmtimi i derës së banesës në të cilën është mbyllur me qëllim që të lirohet), mund të orientohet drejt burimit të rrezikut dhe ta përmbaj neutralitetin e tij, ose në ndonjë drejtim tjetër, në të cilin shpëtimi i të mirës së rrezikuar realizohet përmes viktimizimit të së mirës së ndonjë personi të tretë të pafajshëm.

Veprimi i shmangies së rrezikut ndërmerret derisa rreziku është aktual, përkatësisht derisa viktimja ka pozitë të këtyllë, megjithatë pasoja e saj mund të shfaqet edhe pas ndërprerjes së rrezikut

Instituti i nevojës ekstreme si bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë së veprës së VTQNJ ka karakter subsidiar, meqë e përjashton kundërligjshmërinë vetëm nëse “rreziku nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër” (neni 10 paragrafi 2).

Nuk ka nevojë ekstreme nëse ajo mund të bëhet përmes mënjanimit, arratisjes ose viktimizimit të ndonjë të mire më pak të vlefshme. Mundësia për një gjë të këtillë shqyrtohet në çdo rast konkret, në bazë të një vlerësimit objektiv të situatës së përgjithshme (*ex ante*).

Gjatë tejkalimit të kufirit të nevojës ekstreme (neni 10 paragrafi 3 të KP), VTQNJ mund të dënohet me dënim më të butë ose, në raste të jashtëzakonshme, të lirohet nga dënimi

KP nuk precizon se për cilët kufi bëhet fjalë dhe çka nënkuptohet me tejkalimin e tyre, megjithatë, një gjë e këtillë mund të nxirret nga elementët themelorë të nevojës ekstreme. Kufiri kohor është përcaktuar me kohëzgjatjen e rrezikut akut: nuk përjashtohet kundërligjshmëria e cenimit të të mirave juridike para shkaktimit të gjendjes së rrezikut ose pas ndërprerjes së saj. Tejkalimi ka të bëjë me: nevojën e evitimit të rrezikut pikërisht me cenimin e atyre të mirave juridike dhe të proporcionalitetit të të mirës së rrezikuar dhe të cenuar. Bëhet fjalë për tejkalim në rastet kur viktimja ka mundësi të bëjë përzgjedhjen midis mënyrave të ndryshme të evitimit të rrezikut, kështu që nuk e ka përzgjedhur mënyrën më pak të dëmshme. Ekziston tejkalim edhe atëherë kur krimi i kryer është më i madh se krimi që i është kërcënuar, por vetëm nëse ky dallim nuk është drastik. Nëse dallimi është i madh, atëherë fare nuk ekziston nevoja ekstreme, dhe me këtë as tejkalimi, meqë në këtë rast nuk është përmbushur kushti themelor që ka të bëjë me natyrën subsidiare të këtij instituti: rreziku të mos mund të evitohet në mënyrë tjetër.

KP nuk i precizon rrethanat e tjera lehtësuese për shkak të të cilave kryerësi mundet edhe të lirohet nga dënimi. Ky nocion duhet të interpretohet në kontekstin e dispozitës për tejkalimin e mbrojtjes së nevojshme (neni 9 paragrafi 3): nëse tejkalimi është bërë për shkak të lemerisë ose për shkak të ndonjë gjendje të ngjashme psikike e shkaktuar nga rreziku.



Gjetjet e personit ekspert në lidhje me VTQNJ

...e dëmtuara që kur erdhi në strehimoren “Porta e Hapur” kishte shenja të dukshme të reagimit nga stresi dhe trauma e përjetuar psikike, mbyllje në vetvete, ankth, reagime emocionale, shqetësim, frikë, vuajtje. Personi ekspert sqaroi se e dëmtuara ka përjetuar traumë dhe ka reagim psikik të cilët i ka manifestuar e dëmtuara dhe këto janë reagime që nuk mund të aktrohen, por bëhet fjalë për reagime spontane të përvojave të përjetuara traumatike të stresit...

Nuk përjashtohen edhe disa rrethana tjera lehtësuese që kanë të bëjnë me anën objektive të tejkalimit, siç është rasti i shpëtimit të ndonjë të mire jashtëzakonisht të rëndësishme (për shembull, jeta e njeriut) dhe kur tejkalohej kufiri kohor i caktuar me rrezikun akut. Zbutja ose lirimi nga dënimi është fakultativ, kështu që gjykata në çdo rast konkret duhet të vlerësojë nëse dhe në cilën masë do t’ia zbus dënimin ose do ta liroj kryerësin nga dënimi.

Duke e marrë parasysh faktin se gjatë tejkalimit të kufijve të nevojës ekstreme nuk është përjashtuar kundërligjshmëria e veprës së viktimës, dhe me këtë edhe mundësia e dënimit të saj për veprën e kryer, në mënyrë të veçantë duhet të konstatohet se në këtë rast, sipas të gjitha rrethanave dhe pozitës së veçantë të viktimës e cila e determinon kufizimin e rëndësishëm të lirisë së saj të zgjedhjes, a ka bazë për zbatimin e dispozitës së mosdënimit të parashikuar në nenin 418-a paragrafi 7 dhe nenin 418-g paragrafi 8. Sipas rregullit, kjo dispozitë duhet të zbatohet kur me veprën e kryer nga viktimja në kushtet e përcaktuara me të njëjtën është kryer krim i cili në masë të konsiderueshme nuk është më i madh nga ai që është kërcënuar.

3. Baza e posaçme personale për mosdënimin e viktimës (neni 418-a paragrafi 7 dhe neni 418-g paragrafi 8)

Dispozita për mosdënimin e VTQNJ (neni 418-a paragrafi 7 dhe 418-g paragrafi 8 KP) ka një veprim dhe natyrë komplekse juridike. Nga njëra anë, ajo përmban bazë të posaçme personale për përjashtimin e dënimit, sipas shembullit të bazave tjera të posaçme për përjashtimin e veprës nga Seksioni i veçantë i KP. Këto dispozita përmbajnë norma permisive e që kur përmbushen kushtet të parashikuara me të njëjtat, e përjashtojnë të jashtëligjshmen e veprës: “mos kryej vepër penale” pjesëmarrje në përlëshje personi i cili pa fajin e tij është përfshirë në përlëshje ose vetëm i ka ndarë pjesëmarrësit e tjerë në këtë përlëshje (neni 132 paragrafi 2); “nuk ka vepër penale” zbulimi i paautorizuar i fshehtësisë nëse fshehtësia është zbuluar në interes të përgjithshëm ose në interes të personit tjetër që është më i rëndësishëm se interesi për ruajtjen e fshehtësisë (neni 150 paragrafi 2). Me formulimin “nuk ka vepër penale” përjashtohet kundërligjshmëria, dhe me këtë edhe vepra si e atillë, me të gjitha konsekuencat e mëtutjeshme (përjashtohet ndjekja penale e kryerësit, akuza etj.).

Në dispozita të tjera, siç janë dispozitat për mosdenoncimin e përgatitjes së veprës penale (neni 363 paragrafi 3), mosdenoncimi i veprës penale ose i kryerësit (neni 363 paragrafi 3) dhe ndihmë kryerësit pas kryerjes së veprës penale (neni 365 paragrafi 5) është përdorur formulimi “nuk do të dënohet” ai i cili nuk e ka denoncuar përgatitjen e veprës ose kryerësin për shkak të ndonjë cilësie të caktuar personale (bashkëshort/e e kryerësit të veprës së padenoncuar etj.). për dallim nga bazat e theksuara të posaçme të përjashtimit të kundërligjshmërisë së veprës, me këtë formulim tek këto vepra është futur baza e veçantë subjektive për përjashtimin e dënimit të personit për shkak të ekzistimit të lidhjes së ngushtë farefisnore me kryerësin e veprës penale (i cili nuk e ka denoncuar, përkatësisht e ka ndihmuar). Justifikimi i privilegjit të këtillë qëndron në respektimin e faktit se marrëdhëniet farefisnore dhe familjare dhe lidhshmëria sipas natyrës së gjërave kanë ndikim më të fuqishëm sesa obligimi qytetar për denoncimin e kryerësve të veprave penale: personi nuk mund të qortohet, përkatësisht të shpallet fajtor dhe të dënohet, në rast të kolizionit të ndjenjave të tij farefisnore ose familjare për solidarizim dhe obligimeve qytetare, meqë ka qenë i njëanshëm ndaj asaj që është refleks i natyrshëm mbrojtës. Sipas natyrës së tyre, këto dispozita janë baza subjektive për përjashtimin e dënimit dhe kanë veprim të njëjtë si edhe bazat e përjashtimit të kundërligjshmërisë (nuk ka kallëzim penal, hetim etj.).

Dallimi midis këtyre dy bazave pasqyrohet në zbatimin e instituteve të tjerë të së drejtës materiale penale: nëse përjashtohet kundërligjshmëria – nuk ka vepër penale, nuk ka mundësi për mbrojtje të nevojshme, bashkëpjesëmarrje etj. – ato veprojnë si rrethana objektive (nuk është bashkëpjesëmarrës në përlëshje ai i cili e ka ndihmuar tjetrin i cili ka qenë i involvuar në përlëshjen etj.). Për dallim nga kjo, përjashtimi i dënimit është rrethanë personale që nuk bartet mbi pjesëmarrësit e tjerë të veprës: kështu për shembull, ai i cili e ka ndihmuar personin ta fsheh kryerësin e veprës penale e që është bashkëshorti/ja i/e saj/tij, do të dënohet për ndihmën që ia ka dhënë kryerësit, meqë ai vet nuk ka cilësi subjektive të përcaktuara me dispozitën për mosdënim, konform dispozitës për bashkëpjesëmarrje (neni 25 paragrafi 3), sipas së cilës raportet personale, cilësitë personale dhe rrethanat për shkak të të cilave ligji e përjashton përgjegjësinë penale mund të merren në konsideratë vetëm për pjesëmarrësin e veprës të i cili ekzistojnë. Kështu është edhe me dispozitën e mosdënimin të VTQNJ: cilësia e viktimës, e cila është bazë për zbatimin e dispozitës për mosdënim është cilësi personale dhe merret në konsideratë vetëm për atë person, dhe jo edhe për persona të tjerë që kanë marrë pjesë në veprën të cilën e ka kryer viktimja.

Dispozita për mosdënimin e VTQNJ për vepra të caktuara nuk e përjashton zbatimin e bazave të përgjithshme të përjashtimit të kundërligjshmërisë së tyre, veçanërisht nevojën ekstreme. Kjo nënkupton se kur bëhet fjalë për cilëndo qoftë vepër penale të kryer nga VTQNJ me shtrëngim ose kërcënim me ndonjë krim të rëndë që mund ta shkaktoj trafikanti, do të përjashtohet kundërligjshmëria e veprës, në përputhje me dispozitat për nevojën ekstreme (neni 10 KP), nëse krimi i kryer nuk është më i madh nga krimi që i është kërcënuar viktimës.

Në çdo rast kur VTQNJ ka kryer veprë penale me të cilën e ka tejkualuar nevojën ekstreme, ndërkaq bëhet fjalë për veprë e cila drejtpërsëdrejti ndërlidhet me statusin e saj të VTQNJ dhe është kryer me detyrim në përputhje me dispozitën e veçantë për mosdënim (neni 418-a, paragrafi 7 dhe neni 418-g, paragrafi 8), Kundër saj nuk duhet të ngrihet procedurë penale për shkak të ekzistimit të rrethanës subjektive që e përjashton dënimin

Zbatimi i dispozitës për mosdënimin e VTQNJ mund të merret në konsideratë nëse nuk janë plotësuar kushtet e nevojës ekstreme. Kjo nënkupton se në rastet në të cilat VTQNJ ka kryer veprim me shtrëngim fizik ose psikologjik, ose me kërcënim se nëse nuk e kryen do të rrezikohet jeta e saj ose trupi i saj apo jeta ose trupi i personit të afërt të saj (me çka realizohet esenca ligjore të veprave me shtrëngim, neni 139 ose rrezikimi i sigurisë, neni 144 KP), ose ndaj saj do të kryhet dhunë tjetër (për shembull, privimi i jashtëligjshëm nga liria, neni 140 ose rrëmbim, neni 141 KP) që të detyrohet të kryej ndonjë veprë penale ose të dënueshme, do të përjashtohet kundërligjshmëria e asaj veprë nëse me veprimin e kryer nuk është shkaktuar cenim më i rëndë i të mirave të huaja nga cenimi që i është kërcënuar viktimës. Së këtëjmi, nëse është tejkualuar nevoja ekstreme, në pjesën e tejkalimit tanimë nuk është përjashtuar kundërligjshmëria e veprimit të viktimës dhe ajo mund të përgjigjet për veprën e kryer, nëse në masë të konsiderueshme është tejkualuar masa e evitimit të rrezikut dhe nëse është kryer krim më i madh nga krimi që i është kërcënuar. Në këtë rast viktimë mund të përgjigjet për veprën e kryer penale, me ç'rast konform dispozitës për tejkalimin e nevojës ekstreme (neni 10 paragrafi 3) mund të dënohet me dënim më të butë, ndërkaq nëse tejkalimi është kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese – mund të lirohet edhe nga dënimi.

Mosdënimi i VTQNJ në përputhje me dispozitën e veçantë (neni 418-a paragrafi 7 dhe 418-g paragrafi 8) presupozon plotësimin e dy kushteve:

- Kryerja e veprës penale ose e veprës tjetër të dënueshme nga ana e viktimës e detyruar nga trafikanti derisa ka qenë viktimë; dhe
- Vepra e kryer në mënyrë të drejtpërdrejt të ndërlidhet me pozitën e saj si viktimë, përkatësisht në rastin kur bëhet fjalë për fëmijë – nëse veprimi i tij i këtille është pasojë e drejtpërdrejt e pozitës së tij si viktimë.

4. “E detyruar të kryej veprë penale”

Nocioni “detyrim” i cili përdoret në këtë dispozitë duhet të interpretohet në kuptim më të gjerë, që i tejkalon kufijtë e shtrëngimit si forcë ose kërcënim i drejtpërdrejt mbi jetën ose trupin e viktimës ose mbi persona të afërt të saj dhe siç u theksua më lartë, mund të jetë relevant për zbatimin e institutit nevoja ekstreme. Nga ana tjetër, kryerja e veprës “me detyrim” nuk duhet të ndërlidhet me detyrimin ose me asnjë lloj të dhunës si veprim të kryerjes së trafikimit, duke u nisur nga ajo se vepra mund të kryhet edhe me veprime të tjera duke e vënë personin në gjendje të viktimës: me mashtrim, shpërdorim të detyrës së tij, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore, dhënie ose marrje të pagesave ose dobisë tjetër me qëllim të fitimit të pëlqimit, dhe me veprime të tjera, përkatësisht në mënyrë tjetër përmes rekrutimit, transportimit, transferimit, blerjes etj. Nuk përjashtohen veprimet e premtimit të shpërblimit, përfitimit dhe ngjashëm të cilët janë shkas që viktimë të jep pëlqim për shfrytëzimin e saj (eksploatimin) për qëllimet e kryerësit, i cili nuk është i rëndësishëm për ekzistimin e veprës.

Nocioni “e detyruar të kryej veprë penale” duhet të interpretohet në mënyrë ekstensive, meqë me interpretimin restriktiv dhe trajtimin e tij vetëm si veprime të dhunshme, do të kufizohej zbatimi i dispozitës së mosdënimin dhe do të çonte në përjashtim nga fusha e zbatimit të tij të të gjitha formave tjera të veprimit, me të cilat një person është vënë në pozitë të VTQNJ

Përcaktimi i përmbajtjes së kushtit “e detyruar të kryej vepër penale” duhet të mbështetet në shpjegimin e statusit të viktimës si gjendje e krizës personale, dobësi, varësi, nënshtrim dhe gjendje tjetër për shkak të së cilës viktima nuk mund t’u kundërvihet kërkesave të trafikantit ose pritshmërive të tij të nënkuptuara për ndonjë sjellje të caktuar të saj me të cilën realizohet vepra penale ose vepër tjetër e dënueshme. Kjo është një gjendje e vazhduar e frikës, frikësimit, varësisë, pasigurisë, kufizimit të lirisë së vullnetit dhe zgjedhjes së lirë në sjelljen e saj e krijuar me kërcënime aktuale ose të supozuara që janë jashtë kontrollit të viktimës (B. austral.20). Në gjendje të këtillë viktima nuk ka mundësi të drejt që të veprojnë konform vullnetit të saj të lirë, kështu që tek ajo nuk mund të konstatohet ekzistimi i vullnetit kriminogjen për kryerjen e veprës penale. Së këtejmi, kryerësi i vërtetë i veprës është kryerësi i trafikimit, i cili për veprën e kryer me veprimin e saj duhet të përgjigjet si kryerës i tërthortë. Situata e VTQNJ është e ngjashme me atë të personit i cili është objekt i dhunës në familje, sipas mënyrës me të cilën, me veprime të vazhdueshme të shtypjes së vullnetit të lirë të viktimës krijohet gjendje e vazhdueshme e veçantë e torturës fizike ose psikologjike.

Gjendja e këtillë opresive e VTQNJ, në të cilën është tkurrur liria e saj e zgjedhjes së sjelljes, mund të përcaktohet jo vetëm me hetimin e viktimës, por edhe duke u nisur nga rrethanat objektive të rastit konkret të cilat e vënë në dukje atë se viktima nuk ka pasur rrugëdalje tjetër (kështu për shembull, nëse viktimës i janë marrë dokumentet e udhëtimit ose mbahet në hapësirë të mbyllur nën vëzhgim permanent, pa para, me kërcënimin se do të denoncohet në polici etj.).

Veprimi juridik i shfrytëzimit të pafuqisë, frikës etj. të viktimës çon drejt përjashtimit të dënimit të saj dhe për shkak të pamundësisë që të qortohet nga aspekti social-etnik, i cili është thelbi i fajit, për shkak të gjendjes së veçantë psikologjike në të cilën është involvuar nga ana e trafikantit

KP e kufizon veprimin e kësaj dispozite në vepra të kryera derisa zgjatë pozita e viktimës. Pas ndërprerjes së gjendjes së këtillë, që përputhet me ndërprerjen e kontrollit që ia ka bërë trafikanti, duhet të kuptohet se ndërpritet edhe gjendja opresive, e cila e arsyeton përjashtimin e dënimit dhe viktima duhet të përgjigjet për veprën që e ka kryer.

5. “Vepra penale ose vepër tjetër e dënueshme e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me pozitën e saj të viktimës”

VTQNJ nuk dënohet për vepër penale ose për vepër tjetër të dënueshme të cilën do ta kryej VTQNJ në gjendje frike, kërcënim, nevojë ose mosekzistimi të zgjidhjes tjetër përderisa ka qenë viktima, kur një gjë e këtillë drejtpërsëdrejti ndërlidhet me statusin e saj të viktimës: përpunim ose furnizim të dokumenteve të rrejshme, kalimi kontrabandë i kufirit shtetëror, veprime të ndërlidhura me eksploatimin e saj – prostitucion, lypje, tregti të palejuar etj.

Viktima mund të shtrëngohet të kryej edhe vepra të tjera, siç është vjedhja, shpërndarja e narkotikëve, mashtrimi etj. Nuk përjashtohen edhe veprat penale të kryera me qëllim të lirit të saj ose arratisjes nga kontrolli i trafikantit, siç është dhuna, lëndimi trupor, vrasja e trafikantit etj., të cilat nëse përmbushen kushtet ligjore, mund ta fitojnë kualifikimin e veprave të kryera në mbrojtje të nevojshme

Në të vërtetë veprat e viktimës drejtpërsëdrejti të ndërlidhura me statusin e saj mund të ndahen në tre grupe (Schloenhardt, Markey-Towler, (2016), 14): vepra “statusore”, “shkak-pasoj” dhe “lirose” (ndarje të ngjashme Jovanovic, (2017) 66: statusore, të synuara, sekondare):

- **Statusore** – drejtpërsëdrejti ndërlidhen me vënien e ndonjë personi në pozitë të viktimës dhe kryhen si rezultat i shtrëngimit, kërcënimit ose mënyrës tjetër të viktimizimit të saj nga ana e kryerësit të trafikimit me qenie njerëzore. Nuk ka rëndësi nëse vet viktima e TQNJ është kryerëse e veprave të këtitilla siç është falsifikimi i dokumenteve, ose është bashkëpjesëmarrëse në vepra, kryerësi kryesor i të cilave është trafikanti;
- **Të synuara (shkak-pasojë)** – vepra të cilat viktima i kryen si “instrument” i vullnetit të trafikantit në realizimin e qëllimit të tij që ta eksploatojë në aktivitete të ndaluara dhe të dënueshme (prostitucion, vjedhje të vogla, shpërndarje të drogës, tregti të palejuar, vepra të dhunshme etj.). Edhe tek këto vepra nuk ka rëndësi nëse viktima ka kryer në mënyrë të pavarur vepër të këtitillë ose si bashkëpjesëmarrëse ose si bashkë-kryerëse me trafikantin. Nëse bëhet fjalë për vepër e cila është kryer në mënyrë të pavarur, si kryerës i tërthortë i saj duhet të përgjigjet dhe të dënohet trafikanti nëse kjo vepër është përfshirë në qëllimin e tij për eksploatimin e viktimës dhe është kryer në dobi të tij (ai i mbledh paratë nga shpërndarja e drogës, nga vjedhjet etj.);
- **Çliruese (sekondare)** - viktima nuk dënohet nëse bëhet fjalë për veprime, kryerja e të cilave ka qenë mënyra e vetme e viktimës që të çlirohet nga statusi i skllavërisë, përulësisë, varësisë etj., dhe nëse janë kryer për trafikantin, bashkëpjesëmarrësit e tij ose pronën e tyre. Dënimi i viktimës për vepra të këtitilla është përjashtuar edhe nëse plotësohen kushtet për mbrojtje të nevojshme (neni 9 KP): aktualiteti i sulmit, domosdoshmëria dhe proporcioni i mbrojtjes.

Jashtë këtyre rasteve të nevojës, VTQNJ përgjigjet dhe dënohet për kryerjen ose pjesëmarrjen vullnetare me të tjerë (dhe me vet trafikantin) në vepër penale ose vepër tjetër të dënueshme e cila nuk ndërlidhet me pozitën e saj të viktimës (përdhunim, vrasje, rrezikim të sigurisë në komunikacion, trafikim me qenie njerëzore etj.).

6. Implikime procesuale ndaj VTQNJ

Arritja e qëllimeve të përfshira në dispozitat për mosdënimin e VTQNJ nga KP realizohen edhe përmes instituteve procesual të përfshira në LPP lidhur me viktimat e moshës madhe të TQNJ të cilat, para së gjithash, i ka në dispozicion Prokurori Publik.

VTQNJ nuk duhet të identifikohet me cilësinë procesuale të viktimës në procedurën penale që do të zhvillohet kundër trafikantit me qenie njerëzore, përkatësisht me fëmijë.

Në shumë raste, varësisht nga shteti i origjinës së viktimës potenciale të TQNJ, zbatimi i mundësive procesuale, në masë të konsiderueshme, mund të vështirësohet për shkak të pamundësisë që të sigurohet përkthyes në gjuhën përkatëse të cilën e njih viktima potenciale e TQNJ, dhe për këtë shkak pamundësohet biseda fillestare me të njëjtën ndërsa procedura doemos duhet të shtyhet derisa të krijohen kushte formale për zhvillimin e bisedës.

Nga ana tjetër, edhe pse rekomandohet mbrojtje dhe ndihmë e shpejtë dhe efektive, është fakt se në praktikë koha për ndërmarrjen e aktiviteteve procesuale duhet të harmonizohet me gjendjen psikofizike dhe shëndetësore në të cilën gjendet viktima potenciale e TQNJ.

Në mënyrë që mosdënimi i VTQNJ të jetë efektiv, një gjë e këtitillë nuk e nënkupton vetëm mungesën e sanksionit por edhe mungesën e dosjes kriminale të VTQNJ.

Mosdënimi në vetvete e përmban mosprivimin nga liria dhe mosndjekjen e VTQNJ për veprimet që i ka kryer derisa e ka pasur statusin e VTQNJ ose si pasojë e vet mënyrës së trafikimit me qenie njerëzore

Duke e pasur parasysh faktin se ka vepruar pa vullnetin e saj personal, në përputhje me dokumentet ndërkombëtarë edhe dënimi pa shqiptimin e sanksionit penal nënkuptohet si shkelje e obligimit për mosdënimin e VTQNJ.

Për veprat që i ka kryer VTQNJ për shkak të statusit të viktimës, duhet të ndiqet trafikanti me qenie njerëzore, përkatësisht me fëmijë, i cili ka vepruar në cilësinë e kryerësit ndërmjetës.

VTQNJ nuk duhet të privohet nga liria, të arrestohet dhe të vendoset në institucion për privim nga liria, meqë edhe në këtë mënyrë viktimizohet në aspektin sekondar ndërkaq privimi i këtyllë nga liria nuk mund të konsiderohet si i bazuar dhe i ligjshëm.

Nëse personi i arrestuar identifikohet si VTQNJ, atëherë arrestimi duhet të ndërpritet menjëherë

Mosndërmarrja e ndjekjes penale është mundësi ligjore në kuadër të oportunitetit të zgjeruar për ndjekje penale i cili i jep autorizime prokurorit publik se nuk e ka për detyrë të ndër-marr ndjekje penale në raste të caktuara. Këtë mundësi procesuale prokurori publik duhet ta shfrytëzoj në rastin kur do të konstatoj se një person i caktuar është VTQNJ. Koordinimi i institucioneve kompetente lidhur me identifikimin është jashtëzakonisht i rëndësishëm, me qëllim të miratimit të vendimit të prokurorit për mosndërmarrjen e ndjekjes penale në lidhje me ndonjë person të prekur.

Ndjekja penale nuk do të ndërmerret për shkak të ndryshimit të statusit procesual të personit nga i dyshuar në viktimë, me ç'rast vetëdija e personit është irelevante se është VTQNJ, madje është relevant edhe pëlqimi i tij të bashkëpunoj dhe të jap deklaramë.

VTQNJ mund të jetë pjesë e një grupi ose bande të organizuar në të cilën është gjetur për shkak të gjendjes së viktimës, dhe jo sipas vullnetit personal. Shtrëngimi dhe frika janë shkaqet për shkak të të cilave VTQNJ është bërë pjesë e grupit.

Pozita në të cilën gjendet VTQNJ është shkak i cili e lejon zbatimin e dispozitës për mosprocedimin e ndjekjes penale, madje edhe në rastin kur VTQNJ nuk dëshiron të bashkëpunojë vullnetarisht me organet e ndjekjes

Mosndërmarrja e ndjekjes penale ekziston si mundësi procesuale pa marrë parasysh nëse VTQNJ bashkëpunon dhe është e përgatitur të jap deklaratë e cila është e rëndësishme së jashtëzakonshme për procedurën penale. Në këtë kontekst, mosndërmarrja e ndjekjes penale duhet të shfrytëzohet si mundësi procesuale edhe tek të ashtuquajturat viktima të pavetëdijshme të TQNJ të cilat për shkaqe të caktuara subjektive (shpeshherë emotive) nuk dëshirojnë të besojnë se janë VTQNJ ndërsa trafikantin e shohin si person i cili u ndihmon që të përfitojnë për jetë, në vend që ta shohin si person i cili i eksploaton.

...fakti që VTQNJ ka zhvilluar lidhje emocionale me të akuzuarin, i cili fillimisht e ka ndihmuar financiarisht rreth kujdesit për fëmijën e saj, ndërsa pastaj ka filluar ta eksploatoj për qëllime prostitucioni, ndërkaq i është kundërvënë faktit se është VTQNJ është irelevant për ekzistimin e esencës së veprës penale trafikim me qenie njerëzore...



Rast nga praktika

Prokurori publik duhet të vendos praktikë për të urdhëruar ekspertizë psikologjike për atë se si ndikon gjendja mbi personin, në çfarë marrëdhënie ka qenë me trafikantin, frika, frikësimi, aftësia për të kundërshtuar dhe ngjashëm, me çka do të ndihmohet edhe në identifikimin e nevojave, reziqeve dhe formave të ndihmës që duhet t'i ofrohen VTQNJ.

Ekzistimi i gjendjes së frikës, varësisë, frikësimit, pasigurisë, kufizimit të vullnetit të lirë, kërcënimit ose nevojës tek VTQNJ duhet të konstatohet me ekspertizë psikologjike

VTQNJ duhet të stimulohet që të paraqitet në rolin e dëshmitarit, me qëllim të efikasitetit të luftimit të kësaj forme të kriminalitetit i cili në mënyrë të drejtpërdrejt e rëndon dinjitetin e qenies njerëzore. VTQNJ mund të ofroj të dhëna jashtëzakonisht të dobishme në lidhje me trafikantin me qenie njerëzore, bashkëpjesëmarrësit e tij, dhe me viktimat e tjera të TQNJ, veprat e kryera penale, veprat e planifikuara penale dhe ngjashëm.

Instituti “mbrojtja e dëshmitarëve” duhet të përdoret atëherë kur VTQNJ dëshiron të bashkëpunoj me organet e ndjekjes dhe të jap deklaratë dhe të dhëna për fakte relevante

Çfarë forme e ndihmës do të ofrohet – procesuale ose jashtëprocesuale, varret nga rrethanat e rastit, rreziqet dhe shkalla e rrezikut që ekziston sa u përket VTQNJ. Ndaj VTQNJ, si dëshmitar i rrezikuar sipas dispozitave të LPP mund të ndërmerren masa nga ana e prokurorit publik qysh në procedurën paraprake menjëherë pasi që prokurori publik të pranoj informata për probabilitetin se me dhënien e deklaratës apo me përgjigjet ndaj pyetjeve të caktuara VTQNJ do ta ekspozonte vetveten ose ndonjë person të afërt të saj në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik. Mbrojtjen e VTQNJ si dëshmitar i mbrojtur në seancën kryesore, me propozim të prokurorit publik, e përcakton gjykata me aktvendim të posaçëm kundër të cilit nuk lejohet ankesë. Gjykata e përcakton mënyrën e veçantë të seancës dëgjimore e cila mund të përbëhet ose me kamuflimin e identitetit (dëgjuesë me pseudonim) ose me kamuflimin e dukjes së dëshmitarit të rrezikuar.

Dispozitat e Ligjit të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve zbatohen për veprat penale Trafikim me qenie njerëzore dhe Trafikim me fëmijë duke e marrë parasysh sanksionin e caktuar penal – dënim me burgim prej më së paku katër vjet. Në përputhje me këtë ligj, ndaj VTQNJ mund të aplikohen masa urgjente për mbrojtje: ruajtjen e fshehtësisë së identitetit; sigurimin e mbrojtjes personale ose ndërrimin e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin.

Njëherësh, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, viktimave të cilat paraqiten në cilësinë e dëshmitarëve dhe personat e afërt me ta realizohet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e RMV ose në bazë të reciprocitetit të ndërsjellë.

Në çdo rast, kur do të konstatohet se personi i cili ka ndërmarrë veprime inkriminuese e ka bërë këtë në gjendje të VTQNJ, duhet të pasoj vendim përkatës nga prokurori publik (varësisht nga stadi në të cilin ka arritur veprimi) se nuk ka bazë për ndjekjen e VTQNJ, por për veprimet e ndërmarra të ndiqet trafikanti

Nëse është paraqitur kallëzim penal kundër personit për të cilin pastaj do të konstatohet se në të vërtetë është VTQNJ, prokurori publik e ka për detyrë të marr vendim për hedhjen poshtë të kallëzimit penal në përputhje me dispozitat e LPP, meqë ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë ndjekjen e viktimës, ndërsa për veprimet e ndërmarra nga viktimat duhet të ndiqet trafikanti.

Procedura penale që është ngritur ndaj personit i cili fillimisht ka qenë në cilësinë e të dyshuarit, ndërsa më vonë është konstatuar se është VTQNJ, doemos duhet të ndërpritet. Në rastin kur identifikimi do të bëhet pas lëshimit të Urdhrit për zbatimin e procedurës hetuese, prokurori publik e ka për detyrë të lëshoj Urdhër për ndërprerjen e procedurës hetuese për shkak të ekzistimit të rrethanave të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale.

Gjatë vlerësimit të aktakuzës aktvendim për ndërprerjen e procedurës miraton gjyqtari, përkatësisht kolegji për vlerësimin e aktakuzës, ndërsa në fazën e përgatitjes së seancës kryesore, kryetari i kolegjit.

Nëse statusi i VTQNJ përcaktohet pas hyrjes në fuqi të aktakuzës e deri në fillimin e seancës kryesore, prokurori publik duhet të heq dorë nga ndjekja edhe sa i përket personit të identifikuar si VTQNJ të miratohet aktvendim për ndërprerjen e procedurës, përkatësisht nëse një gjë e këtillë ndodhë pas fillimit të seancës kryesore, atëherë duhet të miratohet aktgjykim për refuzim për shkak të heqjes dorë të prokurorit publik nga ndjekja.

Gjykata mund të miratoj aktgjykim lirues për shkak të ekzistimit të rrethanave të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale ndaj të akuzuarit i cili është identifikuar si VTQNJ në rastin kur prokurori publik nuk ka hequr dorë nga ndjekja, ndërsa gjatë procedurës së dëshmimit në bazë të provave të prezantuara gjykata ka konstatuar se i akuzuari ka qenë VTQNJ.

Në rastin kur gjykata do të konstatoj se VTQNJ ka kryer veprë penale me tejkalimin e nevojës ekstreme, me ç'rast nuk përjashtohet kundërligjshmëria e veprës, varësisht nga rrethanat e rastit konkret gjykata duhet të vlerësoj se a do të zbatohet klauzola e posaçme për mosdënimin e VTQNJ, a do ta dënoj me dënim më të butë ose do ta liroj nga dënimi.

Duke e marrë parasysh faktin se identifikimi i VTQNJ bëhet menjëherë pas zbulimit të veprës së kryer penale, rrethanat në të cilat është kryer e njëjta dhe personat e involvuar në kryerjen e saj, duket e palogjikshme të ketë raste në praktikë kur gjatë procedurës ankimore do të konstatohej se një person ka ndërmarrë veprime të caktuara inkriminuese për shkak të faktit se ka qenë VTQNJ, megjithatë, kjo mundësi, së paku nga aspekti teorik, nuk duhet të konsiderohet si e pamundshme, përkatësisht si pengesë që personi i dënuar me aktgjykim të shkallës së parë ta fitoj statusin e VTQNJ dhe t'i shfrytëzojë mundësitë procesuale të mosdënimin.

VTQNJ duhet t'i vihet në dijeni se i takon kompensim në formën e kërkesës pronësore-juridike. Kompensimi i viktimës realizohet me paraqitjen e kërkesës pronësore-juridike në procedurë penale, ndërsa me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet për fajtor, gjykata vendos plotësisht ose pjesërisht për kërkesën pronësore-juridike.

VTQNJ i nevojitet mbështetje gjatë procedurës penale edhe sa i përket realizimit të kërkesës pronësore-juridike

Mbrojtja e fëmijës VTQNJ fillimisht realizohet në përputhje me mundësitë procesuale të sanksionuara në Ligjin për drejtësi për fëmijë. Nuk kontestohet se është veprim i posaçëm me vëmendje të posaçme kur bëhet fjalë për fëmijë VTQNJ.

Identifikimi i fëmijës VTQNJ duhet të bëhet në fazën më të hershme duke e pasur parasysh vulnerabilitetin e fëmijës, pjekurinë e pamjaftueshme të tij që t'i kuptoj veprimet e ndërmarra dhe pasojat të cilat rezultojnë nga të njëjtat, si dhe për shkak të pamundësisë që ta mbroj vetveten.

Në shtetin tonë, numri më i madh i VTQNJ janë fëmijë, meqë me fëmijët manipulohet më lehtë dhe shfrytëzohet papjekuria e tyre, megjithatë ekzistojnë vështirësi gjatë identifikimit në kushte të trafikimit të theksuar të brendshëm, në rastet kur trafikanti është familjar i afërt me fëmijën kështu që vështirë mund të fitohet një pasqyrë se bëhet fjalë për trafikim, madje edhe për faktin se fëmijët nuk janë çdoherë në gjendje ta kuptojnë situatën në të cilën janë gjendur, nuk denoncojnë me çka në masë të konsiderueshme vështirësohet zbulimi në kohë i trafikimit dhe identifikimit të fëmijës si VTQNJ.

Fëmijët shpeshherë nuk e konsiderojnë vetveten si viktimë të eksploatimit, e që në mënyrë plotësuese e komplikon identifikimin e tyre si viktimë dhe jo si kryerës. Këto viktimë, duke e marrë parasysh moshën dhe pjekurinë, eksploatimin e perceptojnë si diçka normale.

Në mënyrë plotësuese shqetëson fakti se shpeshherë në shtetin tonë trafikantët me qenie njerëzore janë të gjinisë femërore.



Rast nga praktika

- Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike nëna dhe vëllai e kanë shitur vajzën/motrën e tyre për një kompensim paraprakisht të kontraktuar edhe atë dy herë në bazë të martesës së kontraktuar
- Viktimë është shitur nga tezja e saj me qëllim që të lidhë martesë me trafikantin
- Fëmija viktimë është sjell nga një shtet i huaj me mashtrim nga një familjare e saj e cila ka qenë e martuar në shtetin tonë

Nga praktika gjyqësore e kryerjes së veprës penale trafikim me fëmijë mund të konkludojmë se as gjinia e trafikantit nuk ndikon mbi metodat që përdoren.

- Familjarja e viktimës e cila është martuar në shtetin tonë, përveç kërcënimeve verbale ka përdorur edhe forcë fizike me qëllim që fëmija VTQNJ të mos i kundërvihet eksploatimit seksual
- E akuzuara ka përdorur forcë, kërcënim, vënie në lajthitje dhe forma tjera të shtrëngimit (kontrollim përmes marrjes së dokumenteve të udhëtimit dhe ruajtjes së parave të cilat i kanë fituar për "ruajtje") ndaj dy shtetaseve të huaja, prej të cilave njëra fëmijë, për qëllime eksploatimi përmes prostitucionit



Rast nga praktika

Prokurori publik e ka për detyrë të urdhëroj ekspertizë për gjendjen e fëmijës VTQNJ duke e pasur parasysh moshën e tij dhe pjekurinë që ti kuptoj pasojat e trafikimit me fëmijë. Ekspertiza mund t'i besohet psikologut, psikiatrit ose ekipit inter-disiplinor, varësisht nga gjendja e fëmijës. Gjetjet dhe mendimi i personit ekspert duhet të shërbej si burim i informatave për pasojat që trafikimi dhe eksploatimi i ka shkaktuar ndaj fëmijës dhe të përcaktohen masat e nevojshme dhe të domosdoshme për mbështetjen e fëmijës.



Gjetjet e personit ekspert në lidhje me fëmijën VTQNJ

...e mitura ka manifestuar shkallë të lartë të shqetësimit të madh, frikës, ambivalencës për atë se çka do të ndodhte pastaj dhe si do të kuptohej, që është karakteristike për moshën e saj, ka qenë e papjekur në aspektin emocional, social dhe seksual, gjatë deklarimeve e mitura ka qenë konfuzë, shumë e distancuar dhe e rezervuar, pa pasur mundësi ta ndaj të rëndësishmen nga e parëndësishme, si rezultat i shkallës së lartë të çrregullimit psikik e që ka qenë në gjendje akute të stresit...

Fëmijës VTQNJ medoemos duhet t'i sigurohen masat e veçanta të mbrojtjes procesuale si viktima veçanërisht vulnerable në përputhje me dispozitat e LPP, përkatësisht të Ligjit për drejtësi për fëmijë.

Njëherësh, fëmija VTQNJ doemos duhet të trajtohet konform dispozitave për trajtimin e viktimave veçanërisht vulnerable që nënkupton ndihmë nga psikologu, punëtori social ose nga person tjetër profesionist, me përdorimin e mjeteve teknike për transmetimin e fotografisë dhe zërit, pa pjesëmarrjen e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurën në hapësirën në të cilën është fëmija VTQNJ.

Fëmija VTQNJ gjatë procedurës mund ta ndryshojë deklaratën ose të mohoj se diçka i ka ndodhur, shpeshherë i frikësuar nga pasojat nga deklarata e këtillë nga kërcënimet paraprake të trafikantit ose nga persona të afërt me të, bashkëpjesëmarrës etj.

Gjatë procedurës gjyqësore viktima mohon se është mbajtur me forcë në lokal, mohon se atje ka punuar....gjykata ka vlerësuar se deklarata e këtillë është dhënë për shkak të frikës nga hakmarrja nga të akuzuarit ndaj fëmijës viktimë dhe familjes së tij, dhe veçanërisht për shkak të faktit se deklarata e tij ka qenë krejtësisht kontradiktore me të gjitha provat paraprake. Gjykata nuk e ka pranuar deklaratën e ndryshuar të fëmijës VTQNJ meqë ka vlerësuar se ajo e ndryshon deklaratën e saj për shkak të faktit se trafikanti është familjar i afërt i saj me të cilin ka jetuar në familje të njëjtë dhe motivi në të vërtetë buron nga pozita e saj në familje, i cili siç theksoi vet VTQNJ "atje e ka shtëpinë dhe s'ka se ku të shkoj"



Rast nga praktika

Në rast se ka problem që të caktohet mosha e saktë e fëmijës (për shkak të mungesës së dokumenteve, ose në rastin kur posedon dokumente të falsifikuara, nuk është i evidentuar në Librin e amzës të të lindurve edhe pse ka lindur në shtetin tonë dhe ngjashëm), dokumentet ndërkombëtare dhe evropiane rekomandojnë çdoherë të pranohet presupozimi i cili shkon në favor të interesit më të mirë të fëmijës, përkatësisht se bëhet fjalë për fëmijë dhe se është e domosdoshme t'i ofrohet ndihma dhe mbrojtja e nevojshme. Me qëllim që të sigurohen masa të veçanta të mbrojtjes, presupozimi i këtillë është parashikuar në Direktivën e BE të vitit 2012 në lidhje me pozitën e viktimës në procedurën penale (neni 24 paragrafi 2) dhe në

Direktivën e BE në lidhje me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore (neni 13), ndërkohë, çdoherë kur mosha e viktimës është e panjohur ndërsa ekzistojnë shkaqe që të besohet se bëhet fjalë për fëmijë, duhet të veprohet si ndaj fëmijës.

Fëmija VTQNJ nuk guxon të ndiqet, privohet nga liria ose të arrestohet për çfarëdo qoftë vepre penale që e ka kryer përderisa e ka pasur statusin e VTQNJ ose si pasojë e vet aktit të trafikimit me fëmijë. Pëlqimi i fëmijës VTQNJ është jorelevant

Sa i përket fëmijës VTQNJ, krahas mosdënimit me zbatimin e dispozitës të nenit 418-g, paragrafi 8 nga KP, mund të zbatohen dispozitat e Ligjit për drejtësi për fëmijë në lidhje me mundësitë e veçanta procesuale për trajtimin e “fëmijës në rrezik” të cilat e kanë për qëllim mbrojtjen e tij, ndihmën dhe mbështetjen dhe jo sanksionimin dhe zbatimin e masave të cilat e përfshijnë kufizimin ose privimin nga të drejtat.

Mbrojtja e fëmijëve si viktimë dhe si dëshmitarë në procedurën penale sigurohet në përputhje me Ligjin për procedurë penale (LPP) dhe Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Mbështetja e VTQNJ lidhur me kërkesën pronësore-juridike ka të bëjë edhe me fëmijën VTQNJ. Dëshmërimi i fëmijës viktimë bëhet në përputhje me dispozitat e LPP, përkatësisht të Ligjit për drejtësi për fëmijë.

Në lidhje me fëmijët vëmendje e veçantë duhet t’i përkushtohet rasteve të punës me detyrim të fëmijëve, meqë në praktikë mungon identifikimi dhe procesimi i rasteve të këtilla si një nga format e trafikimit me fëmijë. Dyshimi fillestar duhet të paraqitet tek inspektorët e punës, të cilët duhet të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate dhe të jenë të aftë në identifikimin e rasteve të punës së fëmijëve me detyrim. Duhet të theksohet se çdo formë e punës së fëmijëve me detyrim nuk është trafikim me fëmijë, përkatësisht se puna e fëmijëve me detyrim ka një përfshirje më të gjerë nga trafikimi për shkak të eksploatimit të punës.

ANEKSI 1

SHEMBUJ TË DISA VEPRIMEVE TË INKRIMINUARA QË MUND T'I NDËRMARRË PERSONI NË CILËSINË E VTQNJ PËR TË CILAT E MBRON KLAUZOLA E MOSDËNIMIT

Vepra penale:


- Falsifikimi i dokumenteve, Përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë,
- Vepra penale kundër pronës – Vjedhje, Vjedhje e rëndë, Grabitje, Marrja e mjetit motorik, Dëmtimi i sendeve të huaja, Kamuflimi
- Dhunë, Lëndim trupor, Lëndim i rëndë trupor ose vepra penale të cilat e kanë për pasoj privimin e trafikantit nga jeta
- Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, Prodhim i paautorizuar, mbajtje, ndërmjetësim dhe tregtim me armë ose materie shpërthyes
- Nxjerrja jashtë shtetit e të mirave në mbrojtje të përkohshme ose të trashëgimisë kulturore ose rariteteve natyrore, Futja në shtet të të mirave të siguruara në mënyrë të kundërligjshme në mbrojtje të përkohshme, trashëgimisë kulturore dhe rariteteve natyrore, Tregti e paautorizuar me të mira në mbrojtje të përkohshme, trashëgimi kulturore dhe raritete natyrore
- Prodhim i palejuar ose Tregti e palejuar

Kundërvajtje

- Kundër rendit dhe qetësisë publike
 - Prostitucion në vend publik
 - Lypje
 - Bixhoz ose lojë tjetër e fatit
- Kundërvajtje që mund t'i shqiptohen të huajit
 - Hyrje e paligjshme
 - Fshirja ose ndryshimi i të dhënave të vizës
 - Nuk largohet nga shteti në afatin e caktuar
 - Lëvizë dhe qëndron në një zonë të caktuar në të cilën lëvizja ose qëndrimi i të huajve është i kufizuar ose ndaluar
 - Qëndrim i jashtëligjshëm në shtet

ANEKSI 2

VEPRIMI NË RAST TË DYSHIMIT TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE/FËMIJË



BIBLIOGRAFIA

Anti-Slavery International, 2014

Bandović, I., Jovanović, S., Mijalković, S., Ćuk Milankov, D., Prepoznavanje trgovine ljudima (zbirka tekstova), Međunarodna organizacija za migracije (IOM), Beograd, 2008

Explanatory report to the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings, 2005, CETS no. 197.,

EUROPOL Public Information, 2014

EUROPOL Public Information, 2018

General Assembly Resolution on Traffic in Women and Girls, A/RES/55/67, 31.January 2001

General comment No. 24 (2019) on children's rights in the child justice system, Geneva, 2019

Derenčinović, Davor, (2014), Comparative perspectives on non-punishment of victims of trafficking in human beings, Annales de la Faculte de Droit d'Istanbul, 46

Directive 2011/36/EU of the European Parliament and of the Council of 5 April 2011 on preventing and combating trafficking in human beings and protecting its victims, and replacing Council Framework Decision 2002/629/JHA

Directive 2012/29/EU establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA

Jovanovic, Marija, (2017), The Principle of Non-Punishment of Victims of Trafficking in Human Beings: A Quest for Rationale and Practical Guidance, Journal of Trafficking and Human Exploitation, Vol.1, Nr.1

Jovanović, Slađana, Savić, Marijana, (2008), Nacionalni mehanizam upućivanja žrtava trgovine ljudima i Republici Srbiji, Baograd

Child trafficking for exploitation in forced criminal activities and forced begging, EUROPOL, Intelligence Notification 16/2014, The Hague, October 2014

Criminal networks involved in the trafficking and exploitation of underage victims in the European Union - Situation Report, EUROPOL Public Information, Document REF No: 1001370, The Hague, October 2018

Marković, Ivanka, A Case Law Compendium in Trafficking in Human Beings, OSCE Mission to Bosnia and Herzegovina, November 2015

Model Law against Trafficking in Persons, United Nations Office for Drugs and Crime, available at <http://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/2009/July/model-law-on-trafficking-in-persons-.html>, 10 June 2012

Munivrana Vajda, M.; Dragičević Prtenjača, M., Maršavelski A., (2016), Nekažnjavanje žrtava trgovanja ljudima u Hrvatskoj – pravni standard kao fikcija ili stvarnost Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu, god. 53, 4

Non-Punishment and Non-Prosecution of Victims of Trafficking in Persons: Administrative and Judicial approaches to Offences Committed in the Process of Such Trafficking, UN Doc CTOC/COP/WG.4/2010/4 (9 December 2009)

OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Persons, Decision 557, Revision 1, 7 July 2005

Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking, Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights to the Economic and Social Council, E/2002/68/Add.1, 20. May 2002

Regionalne smernice za identifikaciju žrtvata trgovine ljudima, Priručnik za Jugoističnu i Istočnu Evropu, (s.a.), Beograd

Simeunović – Patić, B., Prepoznavanje viktimizacije trgovinom ljudima, TEMIDA, Decembar 2008, str. 69-86

Schloenhardt, Andreas, Markey-Towler, Rebekkah, (2016), Non-Criminalisation of Victims of Trafficking Persons-Principles, Promises, and Perspectives, Groningen Journal of International Law, vol 4(1): International Criminal Organisations

Trafficking for forced criminal activities and begging in Europe, Exploratory Study and Good Practice Examples, Anti-Slavery International, London, September 2014, ISBN 978-0-900918-91-0

The United Nations High Commissioner for Human Rights Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking (included as an addendum to High Commissioner for Human Rights' report to the Economic and Social Council (E/2002/68/Add.1

UNHCHR Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking